

PËRSHKRIMI I VLERËS INVESTIVE

**PËR PROJEKTIN ME TITULL: SEPERACION TË RËRËS KUARCORE, THËRMIM
DHE PËRPUNIM TË GURIT GËLQEROR
ZONA KADASTRALE LANDOVICË KOMUNA PRIZREN
PARASHTRUES I KËRKESËS DHE INVESTITOR
“KALIMASHI 1” SH.P.K.**

Nr.	Emri	Çmimi (€)
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
Shuma totali investive:		

Aplikuesi i projektit:

z. Hasan Kalimashi, **drejtor**

_____ **v.v.**

FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

Numri i lëndës			
Data e aplikimit			
Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet	SEPERACION TË RËRËS KUARCORE, THËRMIM DHE PËRPUNIM TË GURIT GËLQEROR		
Vlera financiare investuese e projektit (në euro)	€		
Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor (në euro)	€		
Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë,		Po	Jo
1. Raporti i VNM-së në një (1) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-së (pronarit të kompanisë së licencuar dhe personave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD).		X	
2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës zonale, kushtet ndërtimore		X	
3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit		X	
4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme).		X	
5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref			
6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar		X	
7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuarit për pëlqim mjedisor			
8. Dëshminë e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor;		X	
9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit		X	
10. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materie eksplozive: Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejimin e vendosjes së rezervuarëve			
11. Aplikuesi ofron një (1) kopje fizike apo elektronike të raportit të VNM-së për Komunën në të cilën planifikohet të realizohet projekti i cili duhet të jetë në dispozicion të publikut.		X	
Emri dhe mbiemri i aplikuesit	z. Hasan Kalimashi		
Kompania	“Kalimashi 1” Shpk		
Adresa e Kompanisë	Landovicë – Prizren		
Tel, fax, E-maili	Tel.: E-mail:		

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR AKTIVITETIN SEPERACION TË RËRËS KUARCORE, THËRMIM DHE
PËRPUNIM TË GURIT GËLQEROR**



Për : “Kalimashi 1” SH.P.K
Titulli i Projektit : Seperacion të rërë kuarcore, thërmim dhe përpunim të gurit gëlqeror
Ngastra kadastrale :P-71813041-00406-0; 00405-0; 00404-0
Vendi i quajtur : ZAROJA-LIVADA; ZAROJA-QERHONE
Zona Kadastrale : Landovicë
Komuna : Prizrenit
Aplikuesi i Projektit :“Kalimashi 1” SH.P.K

Shkurt 2026

Aplikuesi:

Kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k.
Drejtor z. Hasan Kalimashi

Adresa:

Landovicë - Prizren

Tel.: +383

E-mail:

Hartuesi i raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi - Kastrati
Eksperte e licencuar për VNM
Nr. Licencës së lëshuar nga MMPHI:
70/17

Adresa:

Rr. Holger Petersen p.n.

Lagja Prishtina e Re

Prishtinë, Kosovë

Tel.: +383 49 655 661

E-mail: edonak88@gmail.com

Kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k.
z. Hasan Kalimashi, drejtor

_____ v.v.

Hartuese e Raportit:

Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati

Përmbajtja:

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	8
1.1. Të dhënat për aplikuesin	8
1.2. Të dhëna për hartuesit e Raportit të VNM-së	8
1.3. Të dhënat kryesore për projektin	8
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR	9
2.1. Kategoria e projektit të propozuar	9
Rregullativa Ligjore.....	9
2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit	10
2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit	10
2.4. Përshkrimi i detajuar i procesit të planifikimit dhe prodhimit	11
2.5. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme	13
2.6. Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik	14
2.7. Teknologjia e trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbeturinave	15
2.8. Programi i ndërtimit, funksionimit dhe rehabilitimit	16
2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme.....	17
2.10. Aktivitetet shtesë për zbatimin e projektit.....	17
2.11. Lejet dhe licencat e nevojshme.....	17
2.12. Ndërlidhjet e projektit me projekte të tjera.....	18
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR	18
3.1. Emri i lokacionit ku propozohet të zbatohet projekti	18
3.2. Pozita gjeografike, skica dhe planimetria e lokacionit.....	18
3.3. Distanca nga qendrat e banuara dhe objektet përreth	21
3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike.....	22
3.5. Burimi i furnizimit me ujë.....	23
3.6. Karakteristikat klimatike	24
3.7. Karakteristikat natyrore (flora dhe fauna).....	25
3.8. Karakteristikat e peizazhit dhe efektet vizuale.....	26
3.9. Trashëgimia kulturore dhe historike.....	26
3.10. Popullsia dhe karakteristikat demografike	26
3.11. Objektet ekzistuese	27
3.12. Zona të ndjeshme, kërkime shkencore dhe zona me qëllime të veçanta	27
4. GJENDJA EKZISTUESE E MJEDISIT	28
5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	29
5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme.....	29
5.2. Arsye kryesore për zgjedhjen e alternativës së caktuar	30
5.3. Vendndodhja ose rruga	31
5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut.....	31
5.5. Proceset, teknologjia e prodhimit	32
5.6. Metodot e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit	34

5.7. Plani i lokacionit.....	35
5.8. Lloji dhe për zgjedhja e materialeve për realizimin e projektit	35
5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit	36
5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit	37
5.11. Vëllimi i prodhimit.....	37
5.12. Kontrolli i ndotjes	38
5.13. Trajtimi i mbeturinave	38
5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes.....	38
5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit	38
5.16. Trajnime	39
5.17. Monitorimi.....	39
5.18. Planet për situata emergjente.....	39
5.19. Demolimi dhe rehabilitimi.....	39
5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit	40
5.21. Përshkrimi i alternativave pa veprim.....	40
6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS	40
6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis	40
6.2. Cilësia e ajrit.....	40
6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër	41
6.4. Ndikimi i projektit në klimë	41
6.5. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit	42
6.6. Cilësia e ujit	42
6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	43
6.8. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave	43
6.9. Ndryshimet hidromorfologjike	44
6.10. Toka	44
6.11. Ndikimi fizik dhe topografia	45
6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në tokë	45
6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore.....	46
6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur	46
6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike.....	46
6.16–6.19. Popullsia lokale dhe shëndeti.....	46
6.20–6.23. Ndikimet socio-ekonomike	47
6.24–6.26. Ekosistemet dhe gjeologjia	47
6.27–6.29. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve	48
6.30–6.33. Infrastruktura komunale.....	48
6.34–6.35. Ujërat e zeza dhe gjenerimi i mbeturinave.....	48
6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore dhe kulturore.....	48
6.37–6.44. Ndikimet nga implementimi dhe aksidentet.....	49
7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS	49

7.1. Masat e parashikuara me legjislacion	49
7.1.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	49
7.1.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë.....	52
7.1.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë.....	52
7.1.4. Masat për mbrojtje nga zhurma	53
7.1.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peisazh, florë dhe faunë	53
7.1.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	54
7.1.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	54
7.1.7. Menaxhimi i mbeturinave.....	54
8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	55
8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	55
8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të aktiviteteve të projektit	55
8.3. Parametrat për përcaktimin e efektit të dëmshëm.....	55
8.4. Vendndodhjet, mënyra dhe shpeshtësia e matjeve.....	56
8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve	56
8.6. Detyrimi për të informuar publikun	57
8.7. Programi ndërkufitar i monitorimit të ndikimit në mjedis (sipas rastit)	57
9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR	57
9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit	57
9.2. Pajtueshmëria me Pëlqimin Mjedisor	58
9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me ISO 14000	58
10. KONKLUZIONE.....	59
11. BURIMET E TË DHËNAVE - LITERATURA.....	60
12. SHTOJCA.....	60

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1.1. Të dhënat për aplikuesin

Aplikues i projektit është kompania “Kalimashi 1” SHPK, e cila ka selinë në fshatin Lancovicë p.n. komuna Prizren. Përfaqësues i autorizuar i kompanisë dhe aplikues i projektit është z. Hasan Kalimashi i cila mban poziten e drejtorit.

1.2. Të dhëna për hartuesit e Raportit të VNM-së

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është hartuar nga Dr.sc. Edona Kabashi–Kastrati, eksperte e licencuar për VNM me Nr. Licencës 70/17, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH). Raporti është hartuar duke përdorur burime të ndryshme të dhënash dhe duke ndjekur procedurat profesionale të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

1.3. Të dhënat kryesore për projektin

Në kuadër të vazhimit të funksionimit të aktivitetit minerar të separacionit të rërës kuarcore, thërrmimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror nga kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k., me pronar z. Hasan Kalimashi, është hartuar Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), me qëllim pajisjen me Pëlqim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Aktiviteti do të zhvillohet në vendin “ZAROJA-LIVADA; ZAROJA-QERHONE”, në ngastrën nr. P-71813041-00406-0; 00405-0; 00404-0, zona kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit.

Raporti paraqet një dokument të domosdoshëm sipas legjislacionit në fuqi dhe ka për qëllim identifikimin e burimeve të mundshme të ndotjes, vlerësimin e ndikimeve në mjedis dhe përcaktimin e masave për parandalimin ose zvogëlimin e tyre në kufijtë e lejuar. Vlerësimi bazohet në projektin teknik, karakteristikat e lokacionit dhe gjendjen ekzistuese të mjedisit përreth.

Në veçanti trajtohen ndikimet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, zhurmën dhe emetimin e pluhurit të gjeneruar nga procesi i seperimit, thërrmimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, me qëllim ruajtjen e balancës ekologjike dhe mbrojtjen e mjedisit.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet e paraqitura në këtë raport duhet të merren parasysh gjatë funksionimit të aktivitetit, si dhe pas përfundimit të tij.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1. Kategoria e projektit të propozuar

Projekti për zhvillimin e aktivitetit të separacionit, thërrmimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore klasifikohet në kuadër të projekteve të industrisë minerare.

Sipas natyrës së veprimtarisë, hyn në:

Kategoria II – Projekte që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) (për shkak të përpunimit të materialeve minerare, gjenerimit të pluhurit, zhurmës dhe ndikimeve në tokë, ajër dhe peizazh).

Kjo kategori kërkon: Pajisjen me Pëlqim Mjedisor dhe më pas Leje Mjedisore nga (MMPH)

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të aktivitetit të lartëcekur:

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjerë në kufijtë e lejuar.

Rregullativa Ligjore

Me rastin e hartimit të raportit të VNM-së për kompaninë “Kalimashi 1” Sh.p.k. e cila planifikon të zhvilloj aktivitetin e separacionit të rërës kuarcore, thërrmimit dhe klasifikimit të gurit gëlqeror janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të aplikuara të cilat janë paraqitur si në vijim:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.
- Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga ndotja nr. 08/L-025

- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012

Udhëzimit Administrative:

- Udhëzimi administrative (MMPHI) nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin uJOR.
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajer nga burimet e palevizshme te ndotjes.
- Udhëzim administrative Nr.05/2011 për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut nga aksidentet kimike si dhe masat për eliminimin e pasojave.
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2013 për katalogun Shtetëror të mbeturinave.

2.2. Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Për zbatimin e projektit të seperacionit të rërës kuarcore, thërrmimit dhe klasifikimit të gurit gëlqeror, punët përgatitore përfshijnë pastrimin dhe nivelimin e terrenit, shënjimin dhe kufizimin e hapësirës së punës, ndërtimin e rrugëve dhe platformave për makineritë dhe depozitimin e materialeve, si dhe sigurimin e qasjeve për transportin e lëndës së parë dhe produkteve të përpunuara. Në këtë fazë do të instalohet dhe kontrollohet funksionimi i makinerive të thërrmimit dhe separacionit, duke vendosur edhe pajisjet për menaxhimin e pluhurit, zhurmës dhe mbetjeve. Gjithashtu, do të zbatohen masat paraprake mjedisore dhe të sigurisë, duke parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave përreth, dhe duke trajnuar stafin mbi ruajtjen e mjedisit dhe praktikat e sigurisë gjatë zhvillimit të punimeve.

2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi i projektit bazohet në një proces mekanik të vazhdueshëm, i organizuar në dy impiante industriale të ndara:

1. Impianti për separacionin e rërës kuarcore;
2. Impianti për thërrmimin dhe klasifikimin e gurit gëlqeror.

Të dy impiantet përbëhen nga njësi funksionale të ndërlidhura, që sigurojnë rrjedhë të kontrolluar të materialit nga pranimi deri te depozitimi i produktit përfundimtar.

Materiali i papërpunuar pranohet në zonën hyrëse dhe transportohet përmes transportuesve mekanikë në: thërrmimin primar; thërrmimin sekondar; sipas nevojës, thërrmimin terciar; me qëllim arritjen e granulometrisë së kërkuar për procesin e klasifikimit dhe separacionit.

Impiantet operojnë në kushte të kontrolluara teknike, me përdorim të sistemeve për reduktimin e pluhurit (spërkatje me ujë, mbulesa teknike, barriera fizike) dhe izolim akustik në pikat kritike të procesit.

Pajisjet janë të projektuara për operim të vazhdueshëm me mirëmbajtje periodike, duke siguruar stabilitet operacional dhe minimizim të ndërprerjeve. Mbikëqyrja operative dhe procedurat e mirëmbajtjes garantojnë funksionim të sigurt për personelin dhe respektim të standardeve për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin në punë.

Projekti nuk përfshin procese kimike, djegie apo trajtim termik dhe nuk gjeneron ujëra industriale të ndotura. Ndikimi mjedisor kufizohet kryesisht në procese mekanike, të cilat janë të menaxhueshme përmes masave teknike dhe organizative të përcaktuara në këtë raport.

Në këtë mënyrë, impiantet sigurojnë prodhim të qëndrueshëm të materialeve minerare inerte, duke kombinuar efikasitetin teknik me zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore.

2.4. Përshkrimi i detajuar i procesit të planifikimit dhe prodhimit

Kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k., me aktivitet të separacionit të rërës kuarcore, thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror në zonën kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit, do të operon në dy impiante të kompletuar për përpunimin e këtyre materialeve. Pajisjet kryesore të impiantit përfshijnë: seperacioni i rërës kuarcore dhe thërrmuesin primar me nofulla mobile (kapacitet rreth 80 m³/h, bunker pranues rreth 20 m³, dozator vibrues dhe transportues shiritor), thërrmuesin sekondar me çekiça dhe sistemin mobil të separacionit me sitë vibruese të pjerrtë (1530x4800 mm, kapacitet 150 m³/h), si dhe transportues shiritor për dërgimin e fraksioneve në depozitat adekuate.

Procesi teknologjik fillon me ngarkimin e gurit gëlqeror të shkëputur me lëndë plasëse dhe rërës kuarcore të marrë nga kompanitë e licencuara, duke përdorur ekskavatorë dhe kamionë, ku gabaritet e materialit nuk tejkalojnë 900x710 mm. Materialet derdhen në bunkerin pranues dhe përmes dhënësit vibrues ushqehet thërrmuesi primar, ku zvogëlohen dimensionet fillestare. Fraksionet më të vogla (+0–31 mm ose +0–60 mm) transportohen drejt depozitave përkatëse,

ndërsa materialet më të mëdha dërgohen në thërrmuesin sekondar për thërrmim të mëtejshëm dhe prodhimin e fraksioneve të përshtatshme për beton, asfalt dhe ndërtim. Materiali më pas kalon në sitën vibruese për ndarjen sipas fraksioneve dhe çdo material që tejkalon madhësinë e kërkuar rikthehet për thërrmim të dytë, deri në arritjen e fraksioneve të dëshiruara.

Menaxhimi i procesit realizohet nga dhoma e komandës, e pajisur me pult automatik dhe manual. Nisja dhe ndalja e pajisjeve mund të bëhet në mënyrë automatike sipas një rendi të paracaktuar ose manualisht për mirëmbajtje dhe defekte. Impianti përdor energji elektrike (nga trafostacioni i kompanisë), ujë (për sperkatje dhe qëllime sanitare), naftë (për automjetet transportuese dhe ngarkuese) dhe material mineral (guri gëlqeror dhe rëra kuarcore) si komponentë hyrës.

Pajisjet ndihmëse për realizimin e procesit përfshijnë dy ngarkues, dy bager, katër kamionë për transport, një cisternë uji dhe një gjenerator. Komponentët dalës të procesit përfshijnë avuj hidrokarburesh dhe gazra nga automjetet, karburante të djegura, ujëra të ndotura gjatë larjës, zhurmë dhe mbeturina të ngurta. Procesi është i dizajnuar për operim të vazhdueshëm, kontroll teknik dhe minimizim të ndërprerjeve, duke siguruar prodhim efikas të fraksioneve minerale dhe respektimin e masave mbrojtëse mjedisore dhe të sigurisë në punë.


Procesi teknologjik për separimin e rërës kuarcore – Projekti i separimit të rërës kuarcore realizohet në një impiant të specializuar, ku materiali i papërpunuar pranohet, pastrohet dhe ndanë në fraksione të përshtatshme për përdorim industrial. Procesi fillon me pranimin e rërës nga depozitat ose nga sipërfaqja e minierës së licencuar, e cila ngarkohet në bunkerin pranues me ndihmën e ngarkuesve dhe ekskavatorëve. Bunkerit shërben për akumulimin e materialit dhe për ushqimin e vazhdueshëm të pajisjeve të separimit.

Rëra kuarcore transportohet përmes transportuesve shiritor drejt një sistemi sitash vibruese, ku ndahen fraksionet sipas madhësisë së kërkuar nga tregu ose specifikimet teknike. Fraksionet më të mëdha rikthehen në pajisjet e thërrmimit të lehtë ose në procesin e riklasifikimit derisa të arrihet madhësia e dëshiruar. Rëra e përpunuar grumbullohet në depozitat e caktuara sipas fraksioneve dhe është gati për përdorim në beton, asfalt dhe aplikime ndërtimore.

Funksionimi i impiantit realizohet në kushte të kontrolluara teknike dhe përfshin sisteme për reduktimin e pluhurit dhe kontrollin e zhurmës gjatë pikave kritike të procesit. Procesi menaxhohet

nga dhoma e komandës, e pajisur me pult automatik dhe manual, që mundëson nisjen dhe ndalimin e pajisjeve sipas rendit të paracaktuar ose për mirëmbajtje.

Komponentët hyrës të procesit përfshijnë rërën kuarcore, energjinë elektrike (për funksionimin e pajisjeve dhe ndriçimin), ujë (për sperkatje dhe reduktimin e pluhurit) dhe karburant për makineritë transportuese dhe ngarkuese. Komponentët dalës përfshijnë ujëra të ndotura të lehta, pluhur, zhurmë dhe mbeturina të ngurta, të cilat trajtohen sipas masave mbrojtëse mjedisore.



2.5. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme

Për realizimin e procesit të thërrimit, përpunimit të gurit gëlqeror dhe separacionit të rërës kuarcore, kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k. do të përdor burime të kontrolluara dhe të planifikuara, të cilat përfshijnë:

1. Lëndë e parë:

- Guri i gëlqeror i papërpunuar dhe rëra kuarcore, të dy do të sigurohen nga miniera dhe kompanitë e licencuara.
- Sasia e lëndës do të përcaktohet nga kapaciteti i prodhimit dhe planifikimi operativ, në përputhje me kërkesat e tregut dhe standardet teknike të funksionimit.

2. Energji elektrike:

- Përdoret për funksionimin e thërrmuesve, sitave vibruese, transportuesve shiritor, sistemeve të automatizimit dhe pajisjeve ndihmëse.
- Konsumi lidhet me intensitetin e prodhimit dhe orarin e punës së impiantit.
- Furnizimi realizohet përmes trafostacionit të kompanisë.

3. Uji:

- Do të përdoret për seperimin e rërës kuarcore, kontrollin e pluhurit në pikat kritike, për qëllime sanitare dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve, ndërsa furnizimi sigurohet përmes cisternave të kompanisë.

4. Karburantet (nafta):

- Përdoren për automjetet transportuese dhe ngarkuese të impiantit.

5. Burimet njerëzore:

- Përfshijnë personelin për operimin e impiantit, mirëmbajtjen teknike, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit.

Të gjitha burimet planifikohet të shfrytëzohen në mënyrë të kontrolluar dhe racionale, duke respektuar kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në punë dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

2.6. Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Gjatë funksionimit të impiantit për thërrmimin dhe separacionin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, krijohen mbeturina dhe emetime të ndryshme, të cilat lidhen kryesisht me natyrën mekanike të procesit.

Mbeturinat që gjenerohen do të janë kryesisht të natyrës inerte dhe përfshijnë: fraksione shumë të imta minerale, materiale që nuk përmbushin kërkesat granulometrike të tregut, si dhe mbetje nga pastrimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Këto mbeturina konsiderohen jo të rrezikshme dhe, në pjesën më të madhe, ripërdoren ose shfrytëzohen për qëllime teknike brenda impiantit, si stabilizimi i sipërfaqeve operationale. Do të gjenerohen gjithashtu mbeturina komunale, si ambalazhe dhe

materialet e përdorura nga personeli, të cilat grumbullohen dhe dorëzohen tek operatorë të autorizuar.

Emetimet kryesore përfshijnë:

- **Pluhurin** dhe grimcat e imëta që lëshohen gjatë thërrmimit, sitjes dhe transportit të materialit. Shkalla e pluhurit varet nga karakteristikat fizike të gurit dhe rërës, intensiteti i operimit dhe kushtet atmosferike. Për reduktimin e tyre do të përdoren sisteme spërkatjeje me ujë, mirëmbajtje e rregullt e pajisjeve dhe kontroll i rrjedhës së materialit.
- **Zhurmen** e prodhuar nga thërrmuesit, sitat vibruese, transportuesit dhe pajisjet ndihmëse, e cila menaxhohet përmes përdorimit të pajisjeve moderne, mirëmbajtjes së rregullt dhe orarit të punës.
- **Avujt dhe gazrat** shkarkues nga automjetet transportuese dhe ngarkuese që përdorin karburante të lëngshme (naftë).

Procesi nuk përfshin djegie të lëndëve apo përdorim të ujërave të ndotura teknologjike, pasi uji përdoret vetëm për larje të rërës kuarcore, spërkatje dhe nevoja sanitare, duke minimizuar ndikimin mjedisor. Ky organizim i procesit siguron operim të kontrolluar, efikas dhe në përputhje me masat mbrojtëse mjedisore dhe ligjore, duke kombinuar produktivitetin teknik me ruajtjen e mjedisit dhe sigurinë e punonjësve.

2.7. Teknologjia e trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në impiantin e kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k. duhet të realizohet në përputhje me Ligjin mbi Mbeturinën, Udhëzimet administrative për menaxhimin e mbeturinave dhe aktet nënligjore përkatëse. Bazuar në natyrën mekanike të procesit teknologjik, impianti nuk parashihet të prodhon mbeturina që kërkojnë trajtim të veçantë në lokacion.

- **Mbeturinat komunale:** Gjatë operimit të impiantit parashihen të krijohen mbeturina komunale të vogla, të cilat burojnë nga aktivitetet e përditshme të personelit (ambalazhe, materiale të përdorura etj.). Këto mbeturina do të grumbullohen në mënyrë të veçantë dhe dorëzohen tek kompania e kontraktuar nga Komuna për menaxhim të sigurt.

- **Ujërat e ndotura:** Çdo ujë i përdorur për spërkatje apo mirëmbajtje teknike do të trajtohet para shkarkimit në rrjetin ekzistues të kanalizimit. Rekomandohet ndërtimit i vaskave dekantuese për trajtimin e ujit të larjës së rërës kuarcore, pastaj rishikimi periodik i sistemit të trajtimit të ujërave për të siguruar përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe shmangien e ndotjes.
- **Mbeturinat e riciklueshme:** Materialet që mund të riciklohen ndahen nga mbeturinat e tjera dhe dorëzohen tek operatorë të licencuar për riciklim, në bazë të kontratave të lidhura me kompani të specializuara.

2.8. Programi i ndërtimit, funksionimit dhe rehabilitimit

Zbatimi i projektit të kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k. për ndërtimin dhe funksionimin e impiantit për seperacionin të rërës kuarcore, thërrmimin dhe përpunimin të gurit të gëlqeror realizohet në disa faza të ndara kohore, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të kontrolluar dhe funksionimi të qëndrueshëm të impiantit.

Faza e ndërtimit përfshin punimet përgatitore të terrenit, ndërtimin e infrastrukturës së brendshme, instalimin e pajisjeve teknologjike (thërrmues primar dhe sekondar, sitë vibruese, transportues shiritor, makineri ngarkuese dhe kamionë transporti) dhe lidhjen me rrjetet përkatëse të energjisë elektrike, ujit dhe naftës. Kjo fazë planifikohet të zgjasë rreth 2-5 muaj, në varësi të kushteve teknike dhe organizative.

Faza e funksionimit fillon pas përfundimit të ndërtimit dhe testimit të pajisjeve. Impianti i “Kalimashi 1” Sh.p.k. do të operojë në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me lejet dhe autorizimet mjedisore nga MMPH, për aq kohë sa plotësohen kushtet ligjore dhe teknike për funksionim. Gjatë kësaj periudhe menaxhohet procesi i thërrmimit dhe separacionit të gurit dhe rërës kuarcore, kontrolli i mbeturinave dhe emetimeve, si dhe mirëmbajtja periodike e pajisjeve për të garantuar stabilitetin e operimit.

Faza e rehabilitimit parashikon ndërprerjen graduale të operimit dhe çmontimin e pajisjeve teknologjike pas përfundimit të funksionimit të impiantit. Terreni i përdorur do të pastrohet dhe, sipas nevojës, do të kryhen masa rehabilituese, duke përfshirë nivelimin e sipërfaqeve, rivendosjen

e strukturës natyrore dhe rikthimin e zonës në një gjendje të qëndrueshme dhe të sigurt nga aspekti mjedisor.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Për ndërtimin dhe funksionimin e impiantit të “Kalimashi 1” Sh.p.k. me aktivitetin e lartëcekur kërkohet një infrastrukturë bazë teknike dhe funksionale, e cila garanton operim të sigurt dhe të qëndrueshëm të projektit. Lokacioni i impiantit ndodhet në zonën kadastrale Landovicë, komuna e Prizrenit, dhe ka qasje në rrugë ekzistuese, të cilat mundësojnë hyrjen dhe daljen e mjeteve transportuese për furnizimin me lëndë të parë dhe shpërndarjen e produkteve të përpunuara.

Brenda lokacionit janë planifikuar rrugë të brendshme për qarkullimin e mjeteve dhe makinerive, si dhe hapësira për manovrim dhe parkim. Furnizimi me energji elektrike do të realizohet përmes një trafostacioni të ndërtuar brenda impiantit, i pajisur me mbrojtje dhe sisteme kontrolli për funksionim të sigurt të pajisjeve.

Uji i nevojshëm për larje dhe kontrollin e pluhurit në pikat kritike të procesit teknologjik, si dhe për nevoja ndihmëse dhe sanitare, do të sigurohet nga cisternat e impiantit, dhe me lidhje me rrjetin publik të ujësjellësit. Procesi nuk parashikon shkarkim të ujërave të ndotura teknologjike në mjedis, parashihet ndërtimi i vaskave dekantuese për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe duke garantuar funksionim të sigurt të impiantit.

2.10. Aktivitetet shtesë për zbatimin e projektit

Nuk parashihet ndërtimi i objekteve tjera. Aktiviteti realizohet në infrastrukturën ekzistuese.

2.11. Lejet dhe licencat e nevojshme

Për ndërtimin, funksionimin dhe operimin e impiantit të “Kalimashi 1” Sh.p.k., kompania është e detyruar të sigurojë të gjitha lejet dhe licencat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Këto përfshijnë:

1. Pëlqim mjedisor – i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH), pas hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).
2. Licenca e KPMM-së – nga komisioni i pavarur për miniera dhe minerale

3. Leje mjedisore – E nevojshme për operimin e impiantit, përfshirë monitorimin dhe menaxhimin e mbeturinave, ujërave, emisioneve të pluhurit dhe zhurmës.

2.12. Ndërlidhjet e projektit me projekte të tjera

Projekti i ndërtimit dhe operimit të impiantit për seperacion, thërrmimin dhe klasifikimin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore nga “Kalimashi 1” Sh.p.k. ka ndërlidhje të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me projekte të tjera lokale dhe rajonale, duke përfshirë:

1. Projekte infrastrukturore rrugore dhe transporti – Materialet e prodhuara nga impianti në fjalë shfrytëzohen si agregate për ndërtimin e rrugëve, autostradave dhe projekteve të urbanizimit në komunën e Prizrenit dhe zonat përreth. Kjo krijon një lidhje të drejtpërdrejtë me projektet e zhvillimit të infrastrukturës.
2. Projekte të ndërtimit të objekteve – Fraksionet e gurit dhe rërës kuarcore të përpunuara shfrytëzohen për beton, asfalt dhe punime ndërtimore të ndryshme, duke kontribuar në projekte private dhe publike të ndërtimit të ndërtesave dhe objekteve të tjera civile.
3. Projekte të energjisë dhe furnizimit me ujë – Impianti ka lidhje me rrjetet lokale të energjisë elektrike për funksionimin e pajisjeve dhe me burimet e ujit për qëllime operative dhe sanitare, duke siguruar funksionim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm.
4. Bashkëpunime me projekte minerare të licencuara – Lënda e parë e përdorur në impiant sigurohet nga miniera të licencuara dhe mund të lidhet me projekte të tjera minerare për furnizim dhe ripërpunim të materialeve, duke optimizuar zinxhirin e prodhimit mineral në rajon.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Emri i lokacionit ku propozohet të zbatohet projekti

Në parcelat nr. P-71813041-00406-0; 00405-0; 00404-0, me sipërfaqe totale prej 12375 m², në vendin e quajtur “ZAROJA-LIVADA; ZAROJA-QERHONE”, në zonën kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit.

3.2. Pozita gjeografike, skica dhe planimetria e lokacionit

Aktiviteti i planifikuar i kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k. për Seperacion të rërës kuarcore, thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror do të zhvillohet në parcelat nr. P-71813041-00406-0; 00405-0; 00404-0, me sipërfaqe totale prej 12375 m², në vendin e quajtur “ZAROJA-LIVADA; ZAROJA-QERHONE”, në zonën kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit. Toka ka destinim

Tokë Bujqësore – Kullosë, e klasë 5, përkatësisht Livadh i klasës 3 dhe është pronë private e regjistruar në emër të pronarit: Shyqri Kalimashi, gjithnjë sipas fletës poseduese nr. 07-029-959-26, e lëshuar më 03.02.2026. Ngastra posedon kopje te planit dhe nuk është nën masën e komasacionit.

Lokacioni ndodhet rreth 1.150 metra larg lumit Drini i Bardhë dhe dhe me qasje direkte në magjistralen Prizren–Gjakovë, si dhe nga linja hekurudhore që lidh rajonin e Prizrenit me Pejë, Fushë Kosovën dhe Prishtinën. Parcela është e rrethuar kryesisht nga objekte dhe depo, ndersa ne pjeswn veriore me toka bujqësore me kultura sezonale.

Në drejtim jugperëndimor ndodhen fshatrat Gjonaj, Krajkë dhe Zym, në lindje Landovicë dhe Tupec, ndërsa në perëndim dhe veriperndim fshatërat Krushë e Vogël dhe Piranë. Rreth 350 metra larg lokacionit fillojnë disa shtëpi banimi të fshatit Landovicë.

Komuna e Prizrenit, me sipërfaqe prej 640 km², shtrihet në jugperëndim të vendit dhe kufizohet me komunat Gjakovë, Rahovec, Suharekë, Shtërpcë dhe Dragash, si dhe me shtetet Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut. Rrafshi i Prizrenit ka një lartësi mesatare prej 300 m mbi nivelin e detit, ndërsa majat e Maleve të Sharrit tejkalojnë 2,000 m mbi nivelin e detit.

Impianti do të përpunojë dy lloje kryesore të materialeve minerale:

1. Gur gëlqeror – për prodhimin e fraksioneve të ndryshme të agregateve për ndërtim rrugësh, beton dhe asfalt.
2. Rerë kuarcore – për prodhimin e fraksioneve të qëndrueshme dhe të pastërta për aplikime në ndërtim dhe industrinë e betonit, si dhe për përdorim teknik në përgatitjen e betonit dhe asfaltit.

Në afërsi të lokacionit ekzistojnë objekte dhe aktivitete industriale të ngjashme, si separacione të tjera, baza për prodhimin e betonit dhe asfaltit, si dhe depo të materialit ndërtimor, pompa të derivateve, markete, restaurante, etj, të cilat janë të dukshme në pamjet satelitore dhe fotografitë e terrenit të bashkëngjitura më poshtë.



Fig. 2. Pamja satelitore e lokacionit të seperacionit, thërrmimit dhe përpunimit të gurit.




Fig. 3. Situacioni i terrenit nga gjeodeti i licencuar

Më poshtë janë të bashkangjitura fotografi nga terreni dhe parcela se ku është bërë planifikimi i realizimit të këtij projekti.

Foto nga lokacioni:



3.3. Distanca nga qendrat e banuara dhe objektet përreth

Lokacioni ku do të vendoset aktiviteti i seperacionit, therrmimit dhe përpunimit, është e larguar mbi 350m nga objektet banuese më të afërta, kështu që në pikëpamje mjedisore, duke pasur parasysh pozitën gjeografike të lokacionit ku do të realizohet projekti, nuk do të kenë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës do të punësohen në këtë veprimtari është i lartë. Banorët e fshatrave për rreth lokacionit kryesisht merren me bujqësi, pemëtari, blegtori dhe aktivitete e minerare. Në afërsi të lokacionit ekzistojnë objekte dhe aktivitete industriale të ngjashme, si separacione të tjera, baza për prodhimin e betonit dhe asfaltit, të cilat janë të dukshme në pamjet satelitore dhe fotografitë e terrenit të bashkëngjitura më poshtë.




Fig. 4. Distanca nga shtëpit e banimit

3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike

Zona e Landovicës bën pjesë në Rrafshin e Prizrenit dhe karakterizohet nga toka bujqësore me pjellori mesatare deri të mirë. Nga aspekti pedologjik, dominojnë tokat aluviale dhe kambisolike të zhvilluara mbi depozitime lumore dhe formacione karbonatike, me pjellori mesatare deri të mirë dhe me përdorim kryesisht bujqësor. Gjeomorfologjikisht, zona karakterizohet nga reliev kryesisht fushor me pjerrësi të lehtë dhe lartësi mesatare rreth 300–350 m mbi nivelin e detit, me ndikim periferik të masivit të Malet e Sharrit, i cili ka kontribuar në proceset erozive dhe depozituese. Nga pikëpamja gjeologjike, përbërja përfshin depozitime aluviale kuaternare (rërë, zhavorr dhe materiale të imta) në afërsi të Drini i Bardhë, si dhe formacione gëlqerore në zonat kodrinore përreth, duke siguruar stabilitet relativ të terrenit në pjesët fushore. Hidrogjeologjikisht, zona bën pjesë në pellgun e Drinit të Bardhë dhe karakterizohet nga akuiferë aluvialë me përshkueshmëri të mirë dhe thellësi të ndryshueshme të ujërave nëntokësore, gjë që kërkon kujdes në menaxhimin e aktiviteteve që mund të ndikojnë në cilësinë e tyre. Në aspektin sizmologjik, rajoni konsiderohet me aktivitet sizmik mesatar, i lidhur me strukturat tektonike rajonale, prandaj projektimi i objekteve duhet të jetë në përputhje me standardet e ndërtimit antisizmik. Në tërësi, këto

karakteristika natyrore përcaktojnë kushtet bazë mjedisore dhe inxhinierike për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe industriale në këtë zonë.



Përbërja masive Gjeologjike: Rëra, Argjilë me rërë, Argjila & zhavorre.

Mosha: Pliocen, (Pl_{2,3}), nënkati: Piacenzian (3.600 M/vite), dhe Zanclean (5.332 M/vite). Rëra, Argjilë me rërë, Argjila & zhavorre, Aluvione, Proluvion

3.5. Burimi i furnizimit me ujë

Në pjesën e ngastrës ku planifikohet të realizohet ky projekt ka ujëra sipërfaqësore që paraqiten duhet filluar nga distanca 600 metra si gropa të mbushura me ujë të krijuara nga nxerrja e rërës dhe zhavorit, ndërsa në distance rreth 1.15 km kalon lumi Drini i Bardhë. Gjithashtu ujërat e të reshurave atmosferike, drenohen në kanalet natyrore (prrockat) dhe pastaj drenohen në lumin Bistrica e Prizrenit dhe me tutje ne afersi derdhet në lumin Drini i Bardhë, që njëherit paraqet edhe ujëmbledhësin kryesor në këtë rajon.

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prizrenit karakterizohen me ujera të bollshme sipërfaqësore të cilat drenohen në lumin Bistrica, Toplluga dhe Drini i Bardhë, por në bazë të shpimeve të puseve që janë bërë nga komuniteti për nevoja personale dhe informatave të marrura nga ta, thellësitë e ujërave nëntokësore janë mesatare. Ujërat e lumit Bistrica e Prizrenit, Toplluga dhe të Drinit të Bardhë nevojiten për ujitjen e tokave që shtrihen afër shtratit të tij. Furnizimi me ujë për nevojat e kompanisë “Kalimashi 1” shpk me aktivitet përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore merret me cisterna dhe janë të lidhur me rrejtin.




Fig. 5. Distanca nga lumi Drini i Badhë

3.6. Karakteristikat klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë ndër të parat në Evropën juglindore prandaj ekzistojnë përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Hardhia e rrushit, pemët dhe perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për ç’arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasitë e bores me ç’rast në mes të verës mund të zbardhohen majet e maleve.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ulta janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej - 0.5°C.

Regjimi i reshjeve ne komunën e Prizrenit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 670 mm deri ne 820 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 66.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2%. Në komunën e Prizrenit erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226% dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27%, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.7. Karakteristikat natyrore (flora dhe fauna)

Zona rurale përreth fshatrave Landovicë, Gjonaj, Krushë e Vogël, Krushë e Madhe, Zym, Piranë dhe Krajkë, në territorin e Komunës së Prizren, karakterizohet nga një mbulesë bimore tipike e Rrafshit të Dukagjinit me ndikime sub-mesdhetare. Vegjetacioni në hapësirën ku planifikohet aktiviteti industrial është kryesisht i tipit barishtor dhe shkuror sekondar, i zhvilluar mbi toka të degraduara dhe pjesërisht ranore. Hasen barëra shumëvjeçare spontane, manaferra, murrizi, si dhe kaçuba të qarrit, bungut dhe akacies, të përshtatura për substrat argjilor dhe kushte relativisht të thata. Në disa pjesë paraqiten edhe bimë pionere që zhvillohen në sipërfaqe të ekspozuara minerale, çka tregon se parcela ka vlera të kufizuara bujqësore dhe biodiversitet modest lokal.

Fauna përfaqëson një komunitet tipik të zonave agro-pyjore të ultësirës së Dukagjinit. Sipas vëzhgimeve të përgjithshme dhe të dhënave lokale, në këtë hapësirë gjenden gjitarë të zakonshëm si lepuri i egër, dhelpira, ujku, derri i egër dhe iriqi, ndërsa nga brejtësit paraqiten lloje të ndryshme minjsh fushorë. Reptilët përfaqësohen nga gjarpri i zakonshëm, bolla, breshka tokësore dhe hardhuca e gjelbër. Entomofauna është e pasur me insekte të zakonshme të rendit Coleoptera dhe Lepidoptera, si dhe dipterë të ndryshëm. Avifauna përfshin shpendë tipikë të habitateve të hapura dhe bujqësore, si thëllëza e fushës, bilbili, sorrat, çafkat dhe grabitqarë të rastësishëm si shqiponja, si dhe lakuriqët e natës. Në përgjithësi, biodiversiteti i zonës është i zakonshëm për habitatet rurale dhe nuk përfaqëson ekosisteme të ndjeshme apo specie të rralla me rëndësi të veçantë konservuese.

3.8. Karakteristikat e peizazhit dhe efektet vizuale

Karakteristikat e peizazhit në zonën e analizuar, përkatësisht në hapësirën e fshatrave Landovicë, Gjonaj, Krushë e Vogël, Krushë e Madhe, Zym dhe Krajë, në territorin e Komunës së Prizren, përbëjnë një element të rëndësishëm në vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet aktivitetit industrial të planifikuar (separacioni, thërrmimi dhe përpunim i gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore) dhe mjedisit përreth. Peizazhi paraqet një kategori perceptuese me dimension psikologjik dhe afektiv, e cila formësohet nga bashkëveprimi sinergjik i elementeve natyrore (relievi fushor, toka bujqësore, vegjetacioni i ulët, afërsia me Drini i Bardhë) dhe elementeve antropogjene (objekte bujqësore, infrastruktura rrugore dhe aktivitete të tjera industriale ekzistuese). Në këtë perceptim ndikojnë gjithashtu faktorë kulturologjikë, sociologjikë dhe subjektivë të komunitetit lokal.

Efektet vizuale përbëjnë një kriter të rëndësishëm në ruajtjen e cilësisë së mjedisit, pasi ndërhyrjet e pakontrolluara industriale mund të konsiderohen si degradim peizazhor. Duke qenë se zona karakterizohet nga një peizazh rural me hapësira të hapura bujqësore dhe objekte të shpërndara, vendosja e impiantit duhet të harmonizohet me kontekstin ekzistues përmes organizimit racional të hapësirës, sistemimit të materialeve, mbjelljes së brezave gjelbërues mbrojtës dhe minimizimit të ekspozimit vizual të pajisjeve teknologjike. Në këtë mënyrë sigurohet që aktiviteti i planifikuar të mos krijojë ndikime negative të theksuara në pamjen vizuale të zonës dhe të ruajë integritetin peizazhor të mjedisit përreth. Kjo zonë për fatin e keq është dëmtuar shumë nga aktivitetet minerare të nxjerrje së rërës apo zhavorit. Ndërsa ky aktivitet në masë të madhe është zhvilluar qysh pas vitit 1999 dhe vazhdon ende.

3.9. Trashëgimia kulturore dhe historike

Sipas të dhënave zyrtare të institucioneve përkatëse, në lokacionin e impiantit të kompanisë “Kalimashi I” shpk dhe në afërsi të saj nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ose historike, as zona me potencial arkeologjik. Ndërsa në distancë më të largët ose nese flasim për komunën e Prizrenit si zona të veçanta të mbrojtura kemi: Malet e Sharrit, Kalaja e Prizrenit, Ura e Gurit dhe objekte tjera të kultit religjioz.

3.10. Popullsia dhe karakteristikat demografike

Një nga elementet kryesore për vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore të projektit është shpërndarja dhe dendësia e popullsisë në hapësirën përreth lokacionit. Territori i Komunës së Prizren përfshin rreth 640 km² (afërsisht 5.94 % të territorit të Kosovës) dhe përbëhet nga 76

vendbanime me rreth 220,776 banorë, prej të cilëve rreth 110,000 jetojnë në qytetin e Prizrenit. Vendbanimet më të afërta me zonën e projektit karakterizohen nga tipologji rurale, me shtëpi të shpërndara dhe densitet relativisht të ulët banimi, çka zvogëlon potencialin e ekspozimit të drejtpërdrejtë të popullsisë ndaj ndikimeve të mundshme nga aktiviteti industrial.

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të zonës krijojnë parakushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe aktiviteteve rekreative. Rajoni ndodhet përgjatë një korridorit të rëndësishëm natyror që historikisht ka lidhur pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik me bregdetin Adriatik, faktor që ka ndikuar në zhvillimin ekonomik dhe urbanistik të zonës. Kushtet hidrologjike dhe klimatike favorizojnë veçanërisht prodhimin bujqësor, ndërsa resurset natyrore dhe kulturore mbështesin zhvillimin e turizmit rural. Si rezultat, struktura ekonomike e komunës dominohet nga aktivitetet bujqësore dhe turistike, të cilat përbëjnë bazën e zhvillimit socio-ekonomik të popullsisë lokale dhe duhet të merren parasysh gjatë planifikimit dhe operimit të projektit për të shmangur ndërhyrje të panevojshme në cilësinë e jetës dhe aktivitetet ekzistuese ekonomike.

3.11. Objektet ekzistuese

Në zonë janë të pranishme objekte industrial (Pompa të derivateve, depo, markete, restaurante, pastaj separacione, fabrika për prodhimin e Betonit, etj), fabrika për prodhimin e bllokave, pastaj shtëpi të banimit, objekte arsimore dhe infrastrukture, etj. Aktiviteti i propozuar përfaqëson vazhdimësi të funksioneve ekzistuese dhe nuk krijon konflikt me shfrytëzimin aktual të hapësirës, nëse flasim për gjendejen ekzistuese.

3.12. Zona të ndjeshme, kërkime shkencore dhe zona me qëllime të veçanta

Zona ku planifikohet zhvillimi i aktivitetit të lartëcekur ndodhet në një hapësirë kryesisht rurale dhe industriale, me tokë bujqësore kullosa dhe livadhe dhe sipërfaqe të degraduara të mbuluara me rërë dhe bimësi barishtore. Bazuar në të dhënat aktuale dhe shqyrtimet vizuale, nuk janë identifikuar zona të mbrojtura natyrore, parqe kombëtare apo rezervate ekologjike në afërsi të lokacionit, ndërsa nuk rezultojnë as pasuri të dokumentuara arkeologjike ose monumente të kulturës së njohur.

Përsa i përket kërkimeve shkencore, nuk ka studime të thelluara ekologjike ose biologjike që të përqendrohen specifikisht në florën dhe faunën e këtij lokacioni, përveç vërtetimeve paraprake që tregojnë praninë e bimëve barishtore, shkurreve si kaçuba e qarrit, manaferra, akacia, dhe disa

specieve të kafshëve si gjitarë, zvarranikë dhe insekte. Kjo tregon se zona nuk përfshin ekosisteme të ndjeshme ose të rralla, por ka karakter të ekosistemit të zakonshëm rural dhe të degraduar ilegalisht.

Nga ana e zonave me qëllime të veçanta, nuk identifikohen hapësira me destinim turistik, rekreativ, kulturor apo edukativ që mund të ndikohen direkt nga zhvillimi i projektit. Megjithatë, afërsia me vendbanimet rurale dhe rrugët lokale kërkon që aktiviteti i thërrmimit dhe separimit të menaxhohet me kujdes, duke minimizuar zhurmën, pluhurin dhe ndotjen vizuale për të mos ndërhyrë negativisht në përdorimin aktual të territorit dhe për të respektuar nevojat e komunitetit lokal.

4. GJENDJA EKZISTUESE E MJEDISIT

Gjendja aktuale e faktorëve mjedisor në territorin e analizuar të Komunës së Prizrenit karakterizohet nga presione mjedisore të moderuara, kryesisht për shkak të aktivitetit bujqësor, përdorimit të tokës për kulturat sezonale dhe pranisë së aktiviteteve industriale, përfshirë markete, pompa të dreivateve, separacionet, bazat e betonit dhe gurëthyeset lokale. Përveç ndikimeve të natyrës njerëzore, këto zona kanë një ekosistem rural të karakterizuar nga bimësi barishtore, shkurre dhe hapësira me rërë, ndërsa fauna përfshin gjitarë të vegjël, zvarranikë, insekte dhe zogj lokalë.

Degradimi i mjedisit: Problemet kryesore të identifikuara lidhen kryesisht me ndotjen e ajrit nga aktivitetet e thërrmimit dhe separimit, përdorimin e tokës për aktivitete të ndërtimit dhe përpunimit të gurit, si dhe shfrytëzimin e tokës bujqësore për infrastrukturë industriale të vogël. Nuk janë raportuar burime të rënda industriale apo ndotës të mëdhenj të ajrit, por aktiviteti i gurëthyesve dhe transporti me kamionë mund të ndikojnë lokalizuar në cilësinë e ajrit dhe në peizazhin vizual.

Ndotja e ajrit: Ndotja e ajrit është kryesisht lokale dhe lidhet me pluhurin e krijuar nga thërrmimi, sitja, seperiimi dhe transporti i materialeve. Sasia e pluhurit ndryshon sipas intensitetit të operimit dhe kushteve atmosferike, ndërsa masa teknike, si spërkatja me ujë dhe mirëmbajtja e pajisjeve, ndihmojnë në reduktimin e emetimeve. Nuk ka burime të mëdha industriale që gjenerojnë ndotje të vazhdueshme të gazrave.

Ndotja e ujit: Në këto zona nuk ka sisteme të ndotura urbane ose industriale që të shkaktojnë ndotje të konsiderueshme të ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore. Uji i përdorur në impiantet e thërrmimit dhe separimit shfrytëzohet vetëm për kontrollin e pluhurit dhe nevoja ndihmëse, pa shkarkim të ujërave të ndotura teknologjike.

Ndotja e tokës: Tokat rurale janë kryesisht të mbjella me kultura sezonale dhe të përdorura për bujqësi, ndërsa deponitë ilegale janë prezente dhe paraqesin problem të madh. Toka e kësaj ane është degraduar jashtëzakonisht shumë nga aktiviteti minerar i nxjerrjës së rërës dhe zhavorit. Aktivitetet e thërrmimit dhe seperimit mund të shkaktojnë disa sasi mbeturinash inerte, që për pjesën më të madhe rikthehen në proces ose përdoren për qëllime teknike brenda impianteve.

Ndotja akustike: Zhurma është lokale dhe lidhet me aktivitetin e transportit të materialeve dhe funksionimin e pajisjeve të impianteve të thërrmimit dhe separimit. Në afërsi të vendbanimeve, përdoren masa për reduktimin e zhurmës, përfshirë organizimin e orarit të punës dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Në kuadër të projektit të kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k., për aktivitetin e lartëcekur, janë shqyrtuar disa alternativa të mundshme për zbatimin e aktivitetit, me qëllim të identifikimit të opsioneve më të përshtatshme dhe më pak ndikim negativ mjedisor.

Alternativa 1 – Zbatimi i projektit në lokacionin aktual. Kjo alternativë parashikon zhvillimin e impiantit në parcelat nr. P-71813041-00406-0; 00405-0; 00404-0, me sipërfaqe totale prej 12375 m², në vendin e quajtur “ZAROJA-LIVADA; ZAROJA-QERHONE”, në zonën kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit. Toka ka destinim Tokë Bujqësore – Kullosë, e klasë 5, përkatësisht Livadh i klasës 3 dhe është pronë private e regjistruar në emër të pronarit Shyqri Kalimashi dhe ka qasje të mirë në rrugët ekzistuese për transportin e lëndës së parë dhe produkteve të përpunuara.

- Avantazhet: Qasje e mirë infrastrukturore, pronësi private e tokës, kontroll i lehtë i procesit dhe menaxhimi i impiantit.
- Disavantazhet: Afërsia e lokacionit me disa shtëpi të banimit (rreth 350 m) mund të shkaktojë shqetësime të lehta akustike ose vizuale për komunitetin, prandaj do të nevojiten masa për reduktimin e pluhurit dhe zhurmës. Poashtu dëmtim i tokës bujqësore.

Alternativa 2 – Lokacion tjetër në zonë të largët me tokë private; Kjo alternativë shqyrton vendosjen e impiantit në një pjesë të tokës bujqësore më të largët nga vendbanimet dhe rrugët kryesore, për të reduktuar ndikimet e mundshme në popullatë dhe peizazh.

- **Avantazhet:** Minimizon ndikimin vizual dhe akustik tek komuniteti, lehtëson menaxhimin e pluhurit dhe mbeturinave.
- **Disavantazhet:** Kosto më e lartë për blerjen e parcelës, ndërtimin e rrugëve të brendshme dhe lidhjen me energjinë elektrike, ujë dhe transportin e lëndës së parë.

Alternativa 3 – Moszbatimi i projektit (alternativa zero) Në këtë variant, projekti nuk do të realizohet. Ky opsion nuk gjeneron ndikime negative mjedisore, por pengon zhvillimin ekonomik të kompanisë dhe përdorimin e resurseve minerare të zonës.

- **Avantazhet:** Nuk ka ndikim negativ në mjedis, komunitet apo peizazh.
- **Disavantazhet:** Nuk krijohen vende pune, nuk realizohet prodhim i agregateve për ndërtim dhe nuk shfrytëzohen burimet minerale.

Vlerësimi i alternativave: Nga analiza e kryer, **alternativa 1** rezulton të jetë më e favorshme duke marrë parasysh kombinimin e qasjes së mirë në infrastrukturë dhe pronësinë private të tokës. Për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe sociale, do të aplikohet një paketë masash mbrojtëse, përfshirë: spërkatje me ujë për kontrollin e pluhurit, mbulim të transportit të materialeve, përdorim të barrierave akustike, organizim të orarit të punës për të reduktuar shqetësimet tek banorët, dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të përdorura pas përfundimit të operimit.

5.2. Arsye kryesore për zgjedhjen e alternativës së caktuar

Alternativa e zgjedhur për realizimin e projektit të kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k., që parashikon ndërtimin dhe operimin e impiantit për thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore në parcelat nr. P-71813041-00406-0; 00405-0; 00404-0, me sipërfaqe totale prej 12375 m², në vendin e quajtur “ZAROJA-LIVADA; ZAROJA-QERHONE”, në zonën kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit është konsideruar si opsioni më i favorshëm për arsyet e mëposhtme:

1. **Qasje e favorshme infrastrukturore:** Lokacioni është afër rrugëve ekzistuese kryesore dhe rrugëve lokale të cilat lehtësojnë transportin e lëndës së parë dhe shpërndarjen e produkteve të përpunuara, duke reduktuar kostot operative dhe kohën e transportit.
2. **Pronësi private e tokës:** Parcela është në pronësi të investitorit dhe është në dispozicion të investitorit, gjë që siguron stabilitet ligjor dhe shmang procedurat komplekse të ekspropriimit apo negociatave shtesë.
3. **Reduktim i ndikimeve negative:** Pavarësisht afërsisë me disa shtëpi të banimit, lokacioni mundëson zbatimin e masave mbrojtëse për të reduktuar pluhurin, zhurmën dhe ndikimin vizual, duke siguruar një integrim më të mirë në peizazhin përreth.
4. **Mundësi për zhvillim të qëndrueshëm:** Lokacioni ofron hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e infrastrukturës brenda impiantit, përfshirë rrugët e brendshme, zonat për manovrim të mjeteve, depozitimin e lëndës së parë dhe të produkteve përfundimtare, si dhe hapësira për rehabilitim pas përfundimit të operimit.
5. **Minimizim i kostove të jashtme:** Alternativat e tjera, si lokacione më të largëta, do të kërkonin investime të konsiderueshme në rrugë, energji dhe ujë, duke e rritur ndjeshëm koston totale të projektit.

5.3. Vendndodhja ose rruga

Lokacioni i planifikuar për vendosjen e impiantit të separacionit të rërës kuarcore dhe thërrmimit të gurit gëlqeror ndodhet në një pozicion strategjik lidhur me rrjetin rrugor dhe transportues të rajonit. Ai është lidhur direkt me magjistralen Prizren–Gjakovë dhe linjën hekurudhore që lidh rajonin e Prizrenit me Fushë Kosovën dhe Prishtinën, duke mundësuar transport të shpejtë dhe efikas të lëndës së parë dhe produkteve të përpunuara.

Në pjesën lindore ka dalje në rrugën rajonale Prizren–Gjakovë, e cila më pas lidhet me autostradën “Ibrahim Rugova”. Kjo autostradë mundëson lidhje të drejtpërdrejtë me Shqipërinë në jug dhe pjesën verilindore të Kosovës dhe Maqedoninë e Veriut, duke siguruar transport ndërkombëtar dhe brenda vendit me efikasitet të lartë.

5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Gjatë fazës së ndërtimit të impiantit të separacionit dhe thërrmimit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, priten ndikime të përkohshme në mjedis, të cilat lidhen kryesisht me aktivitetet fizike të ndërtimit. Këto përfshijnë:

- Pluhuri, që mund të gjenerohet nga lëvizja e makinerive dhe punimet tokësore;
- Zhurma, e shkaktuar nga mjetet e rënda dhe pajisjet e ndërtimit;
- Lëvizja e mjeteve transportuese dhe makinerive, që mund të ndikojë përkohësisht në qarkullimin lokal dhe stabilitetin e tokës.

Të gjitha këto ndikime mund të janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë dhe do të menaxhohen me masa parandaluese, përfshirë spërkatjen e rregullt të sipërfaqeve për kontrollin e pluhurit, përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes individuale për punonjësit dhe organizimin e orarit të punës për të minimizuar zhurmën dhe përplasjet me trafikun lokal.

Gjatë fazës së operimit, ndikimet mjedisore dhe ato mbi shëndetin e njeriut janë të kontrollueshme dhe mbahen brenda kufijve të lejuar, për arsytet e mëposhtme:

- Procesi kryhet mekanikisht, pa përdorimin e substancave kimike të rrezikshme;
- Nuk gjenerohen ujëra të ndotura teknologjike, pasi uji përdoret vetëm për larje dhe kontrole pluhuri dhe nevoja ndihmëse;
- Emetimet e pluhurit dhe zhurma monitorohen dhe menaxhohen nëpërmjet sistemit të spërkatjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve;
- Aktiviteti është i strukturuar në mënyrë që të minimizojë kontaktin e drejtpërdrejtë të personelit dhe banorëve me zonat e punës.

5.5. Proceset, teknologjia e prodhimit

Kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k planifikon realizimin e dy projekteve të ndara dhe të pavarura, të cilat do të funksionojnë në të njëjtin lokacion, por me linja të veçanta teknologjike:

1. Impianti për seperimin e rërës kuarcore

Ky projekt është i fokusuar vetëm në përpunimin dhe separimin e rërës kuarcore. Lënda e parë futet në impiant përmes bunkerëve dhe ushqyesve mekanikë, të cilët sigurojnë dozimin e kontrolluar.

- **Procesi kryesor:**
 - Materiali kalon përmes transportuesve dhe sitave vibruese për klasifikim sipas madhësisë së grimcave.
 - Fraksionet që nuk përmbushin kriteret rikthehen në proces për ripërpunim.

- Sistemet e kontrollit të pluhurit (spërkatje me ujë) përdoren në pikat kritike të përpunimit.
- **Veçoritë e impiantit:**
 - Nuk përdoren procese kimike apo djegie.
 - Nuk prodhohen ujëra të ndotura teknologjike.
 - Përdorimi i rërës kuarcore është i kontrolluar dhe fraksionet e prodhuara janë për tregun e ndërtimit dhe industrinë e betonit dhe asfaltit.

2. Impianti për thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror

Ky projekt është i fokusuar në thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror në fraksione të ndryshme për ndërtim rrugësh, beton dhe asfalt. Materiali i parë pranohet në impiant dhe futet në linjën e përpunimit përmes bunkerëve dhe ushqyesve mekanikë.

- **Procesi kryesor:**
 - Thërrmimi primar dhe sekondar përmes thërrmuesve industrialë (nofullorë dhe çekiçë).
 - Transportimi i materialit ndërmjet fazave përmes transportuesve shiritorë.
 - Klasifikimi i fraksioneve në sitat vibruese dhe kthyerat për ripërpunim, nëse nuk përmbushin kërkesat granulometrike.
 - Kontroll i pluhurit përmes spërkatjes me ujë.
- **Veçoritë e impiantit:**
 - Proces mekanik pa përdorim kimik ose djegie.
 - Nuk gjenerohen ujëra të ndotura teknologjike.
 - Fraksionet e prodhuara përdoren për tregun e ndërtimit dhe industrinë e betonit dhe asfaltit.

Përfitimet e ndarjes së projekteve:

- Secili impiant funksionon në mënyrë të pavarur, duke lejuar prodhimin paralel të dy materialeve të ndryshme (gur gëlqeror dhe rërë kuarcore).
- Reduktohet ndërhyrja dhe ndotja e mundshme e materialeve të përpunuara.

- Proceset e kontrollit të pluhurit dhe menaxhimit të mbeturinave mund të optimizohen për secilin projekt veç e veç.
- Lehtësohet menaxhimi i kapaciteteve të impiantit dhe planifikimi operativ.




Fig. 6. Skemat e procesit teknologjik të seperacionit dhe therrimit dhe klasifikimit

5.6. Metodatat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projekteve të kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k., si për separimin e rërës kuarcore, ashtu edhe për thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror, bazohen kryesisht në përdorimin e makinerive dhe pajisjeve industriale standarde.

Gjatë fazës së ndërtimit, punimet do të kryhen sipas planit të detajuar të organizimit të terrenit dhe instalimit të pajisjeve, duke përfshirë ndërtimin e bunkerëve pranues, linjave të transportuesve, vendosjen e sitave vibruese dhe depozitimin e fraksioneve të ndara. Çdo aktivitet realizohet me respektim të masave të sigurisë për personelin dhe mbrojtjen e mjedisit, përfshirë kontrollin e pluhurit dhe menaxhimin e trafikut të mjeteve të rënda.

Gjatë operimit, impianti funksionon në mënyrë të organizuar dhe të planifikuar, duke siguruar dozimin e kontrolluar të lëndës së parë, thërrmimin dhe klasifikimin sipas fraksioneve të kërkuara.

Pajisjet mbahen me mirëmbajtje të rregullt teknike, inspektime periodike dhe monitorim të performancës për të garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe efikas.

Gjithashtu, gjatë operimit zbatohet kontrolli i pluhurit në pikat kritike të procesit përmes spërkatjes me ujë, ndërsa menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave sanitare realizohet sipas procedurave ligjore dhe të standardeve mjedisore. Ky model i punës siguron që operimi i impiantit të jetë efikas, i sigurt për punonjësit dhe i minimizuar për ndikimet negative në mjedis.

5.7. Plani i lokacionit

Plani i lokacionit për kompaninë “Kalimashi 1” Sh.p.k., për të dy projektet – separimin e rërës kuarcore dhe thërrmimin e klasifikim të gurit gëlqeror – përfshin organizimin funksional të impiantit në mënyrë që të sigurohet rrjedhë e efektshme e procesit teknologjik dhe qarkullim i sigurt i mjeteve dhe personelit.

Në plan janë të përcaktuara zonat e përpunimit të materialeve, duke përfshirë bunkerët pranues, linjat e thërrmimit primar dhe sekondar, sitat vibruese për klasifikimin e fraksioneve, transportuesit shiritorë dhe depozitat për produktet përfundimtare.

Rrugët e brendshme janë projektuar për qarkullim të mjeteve transportuese dhe makinerive ngarkuese, duke mundësuar hyrje dhe dalje të kontrolluar dhe pa pengesa nga një pjesë e impiantit në tjetrën.

Trafo-stacioni i dedikuar siguron furnizim me energji elektrike të qëndrueshme për të gjithë pajisjet e impiantit, duke përfshirë sistemet e thërrmimit, sitat, transportuesit dhe sistemet ndihmëse.

Hapësirat ndihmëse përfshijnë zona për mirëmbajtje të makinerive, magazinim të rezervave dhe karburanteve, hapësira administrative dhe sanitare për punonjësit. Ky plan i lokacionit është i strukturuar për të mundësuar funksionim efikas, siguri operative dhe respektim të standardeve mjedisore.

5.8. Lloji dhe përzgjedhja e materialeve për realizimin e projektit

Për ndërtimin dhe operimin e impianteve të kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k., për aktivitetet e thërrmimit dhe separacionit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, përdoren materiale ndërtimore dhe industriale të standardit të lartë, të përzgjedhura në përputhje me kërkesat teknike, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

1. Materialet kryesore ndërtimore:

- Çelik dhe beton i armuar: Përdoren për bazamentet e pajisjeve, strukturat mbështetëse dhe platforma për thërrmuesit, sitat vibruese dhe transportuesit me rripa. Sigurojnë stabilitet, qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të impiantit.
- Materiale inerte dhe agregate të përzgjedhura: Përdoren për ndërtimin e rrugëve të brendshme, hapësirave për manovrim dhe parkim të mjeteve dhe makinerive të rënda, duke garantuar akses të sigurt dhe funksionalitet gjatë operimit.

2. Materialet për pajisjet teknologjike:

- Thërrmues industrialë (primar dhe sekondar), të prodhuara nga materiale rezistente ndaj korrozionit dhe të certifikuara për përdorim në industrinë minerare.
- Sitat vibruese dhe transportuesit me rripa, për klasifikimin e materialit sipas madhësisë së fraksioneve dhe për lëvizjen e kontrolluar të materialit gjatë procesit.
- Sistemet e automatizimit dhe pultet komandues, të prodhuara nga materiale industriale rezistente, që mundësojnë kontroll të vazhdueshëm dhe të sigurt të impiantit.

3. Materialet ndihmëse dhe mbrojtëse:

- Pajisje për kontrollin e pluhurit, si spërkatës me ujë në pikat kritike të përpunimit të materialit, për reduktimin e emetimeve të pluhurit.
- Materiale për mbrojtje dhe mirëmbajtje të pajisjeve (karburant për automjetet dhe ngarkuesit, lubrifikantë për thërrmuesit, dhe elementë të sigurisë industriale).

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Ekzekutimi dhe funksionimi i impiantit për thërrmimin dhe separacionin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore do të realizohet në faza të planifikuara, në përputhje me ligjin dhe udhëzimet administrative për mjedisin, ndërtimet dhe aktivitetet industriale. Afatet e kryesore janë si më poshtë:

1. Faza e ndërtimit:

- Përfshin: përgatitjen e terrenit, ndërtimin e infrastrukturës dhe bazamentit të pajisjeve, instalimin e thërrmuesve, sitave vibruese, transportuesve me rripa dhe sistemit të automatizimit, si dhe lidhjen me rrjetin energjetik dhe rrugët e brendshme.
- Kohëzgjatja: parashikohet të zgjasë 3–6 muaj, në varësi të kushteve teknike, kapaciteteve të punës dhe organizimit të logjistikës.

2. Faza e testimit dhe fillimit të operimit:

- Pas përfundimit të ndërtimit dhe instalimit të pajisjeve, realizohen testime funksionale për të siguruar operim të sigurt dhe efikas.
- Testimet përfshijnë: kontrollin e thërrmuesve, transportuesve, sistemeve të sitës, mekanizmit të automatizimit, si dhe masat për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës.

3. Faza e operimit afatgjatë:

- Impianti do të funksionojë pa kufizim të paracaktuar kohor, për atë kohë sa plotësohen kushtet ligjore dhe teknike për operim, përfshirë: lejet e mjedisit, licencat për operim industrial dhe kontrollet periodike të sigurisë dhe mirëmbajtjes.
- Menaxhimi i impiantit përfshin operim të organizuar, mirëmbajtje të rregullt dhe monitorim të vazhdueshëm të pajisjeve dhe ndikimeve mjedisore.

4. Faza e rehabilitimit dhe mbylljes së aktivitetit:

- Në rast të ndërprerjes së operimit, aktiviteti do të ndërpritet gradualisht, me çmontimin e pajisjeve dhe pastrimin e lokacionit.
- Masat rehabilituese përfshijnë nivelimin e terrenit, largimin e mbeturinave, dhe rikthimin e tokës në gjendje të qëndrueshme nga aspekti mjedisor dhe estetik.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

1. Sipërfaqja totale e lokacionit:

- Parcelat e planifikuara: 12375 m², në vendin “ZAROJA-LIVADA; ZAROJA-QERHONË”, në zonën kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit.
- Pjesa kryesore e lokacionit ku do të vendosen impiantet (separacioni, thërrmuesi, sitat vibruese, transportuesit dhe bunkerët) është rreth 1200 m², duke lënë pjesën tjetër për rrugë të brendshme, hapësira manovrimi, parkim për automjete dhe zona ndihmëse.

2. Organizimi funksional i hapësirave:

- Zona e thërrmuesve primar dhe sekondar: ~600 m²
- Zona e separacionit dhe sitave vibruese: ~600 m²
- Rrugët e brendshme dhe manovrimi: ~800 m²
- Hapësira për trafostacion, cisterna dhe objekte ndihmëse: ~150 m²
- Depozitat për materiale të thërrmuara dhe fraksione të ndara: ~750 m²

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i prodhimit për thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore:

- Thërrmuesi primar (me nofulla mobile):

- Kapacitet teorik: 40 - 60 m³/orë
- Kapacitet operativ: 23 m³/orë
- Thërrmuesi sekondar (mulliri me çekiça):
 - Kapacitet teorik: 60 m³/orë
 - Kapacitet real: 40 m³/orë
- Sitat vibruese dhe separacioni:
 - Kapacitet i sitës: 150 m³/orë
 - Fraksionet e prodhuara: +0-31 mm, +31-60 mm, sipas kërkesave për beton dhe asfalt
- Vëllimi total i prodhimit të përditshëm:
 - Duke funksionuar 8–10 orë në ditë, prodhimi mund të arrijë rreth 240–400 m³ material të thërrmuar dhe të klasifikuar në ditë, varësisht nga intensiteti i operimit dhe fraksionet e kërkuara.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Janë parashikuar masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe ndikimeve të tjera mjedisore.

5.13. Trajtimi i mbeturinave

Nuk parashihet trajtim i mbeturinave në lokacion. Mbeturinat komunale merren nga kompania e kontraktuar nga Komuna. Duhet bërë mbledhje dhe dorëzim për trajtim nga kompani të licencuara;

5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes

Qasja realizohet përmes infrastrukturës ekzistuese rrugore, e cila është e zhvilluar dhe e mjaftueshme. Përmirësim i vazhdueshëm i gjendjes së rrugëve të brendshme.

5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit

Personeli përgjegjës i autorizuar duhet të monitoron sistematikisht treguesit mjedisor. Raportimi i rezultateve të monitorimit do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, përkatësisht nga ekspertët e kompanisë. Raporti do të përfshijë të dhëna të detajuara mbi të gjithë parametrat e monitoruar, sipas kërkesave të Pëlqimit Mjedisor dhe lejes mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Raportet do të

dorëzohen në kohë dhe në formë të dokumentuar për të garantuar transparencë dhe përputhshmëri me legjislacionin mjedisor.

5.16. Trajnime

Personeli do të trajnohet për përdorimin e pajisjeve, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

5.17. Monitorimi

Duke u bazuar në gjendjen faktike në terren dhe natyrën e aktivitetit, i cili nuk paraqet presion të lartë mjedisor, monitorimi i detyrueshëm dhe i vazhdueshëm i treguesve mjedisor konsiderohet i domosdoshëm për sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm.

5.18. Planet për situata emergjente

Janë parashikuar procedura për reagim në raste emergjente, përfshirë zjarrin dhe ndaljen e pajisjeve.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Pas përfundimit të aktivitetit minierar, të gjitha pajisjet dhe makineritë e impiantit duhet të çmontohen dhe të largohen nga lokacioni. Bazamentet dhe platotë e ndërtuara gjatë operimit të impiantit do të shkatërrohen, imtësohen dhe materialet e tyre do të dërgohen në deponimet rajonale të përshtatshme.

Struktura përfundimtare e zonës duhet të mbulohet me dheun adekuat, në përputhje me substratin ekzistues të tokës, në mënyrë që të rikthehet ekuilibri natyror i tokës. Rikultivimi i sipërfaqeve të dëmtuara nga aktiviteti minierar përfshin rivitalizimin e plotë të hapësirës, duke e kthyer atë në funksionin e saj primar ose në përputhje me destinacionin e ri të tokës, sipas planeve komunale dhe kërkesave të përdorimit të tokës.

Për rikultivimin, modeli dhe llojet e bimëve do të zgjedhen në përputhje me qëllimin e përdorimit të tokës dhe karakteristikat e ambientit rrethues. Për hapësirat që mund të mbjellen, rekomandohet përdorimi i bimëve lokale dhe kulturave bujqësore tradicionale, në mënyrë që të ruhet biodiversiteti dhe të minimizohet ndikimi negativ i aktivitetit në ekosistem. Kjo procedurë siguron rikthimin e zonës në një gjendje të ngjashme me ambientin përreth dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të ekosistemit lokal.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani përfshin masa parandaluese, monitoruese dhe korrektuese për të gjitha fazat e projektit, me qëllim minimizimin e ndikimeve negative.

5.21. Përshkrimi i alternativave pa veprim

- Pa veprim, mjedisi (toka, uji, ajri) nuk do të përballlet me ndikime të drejtpërdrejta nga aktiviteti mineral;
- Nuk do të sigurohet furnizim i qëndrueshëm me rërë;
- Nuk do të krijohen vende të punës dhe nuk do të zhvillohet infrastruktura industriale e zonës;

Si përfundim, alternativa e zgjedhur, lokacioni aktual dhe teknologjia e propozuar mund të konsiderohet më e përshtatshme duke siguruar efikasitet operativ, minimizim të ndikimeve në mjedis dhe përfitime socio-ekonomike për komunitetin lokal.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis

Projekti përfshin dy procese mekanike industriale: separacionin e rërës kuarcore dhe thërrmimin, klasifikimin e gurit gëlqeror. Aktivitetet zhvillohen pa procese kimike, pa djegie industriale dhe pa krijim të ujërave teknologjike, prandaj ndikimet mjedisore janë kryesisht fizike dhe të lokalizuara.

6.2. Cilësia e ajrit

Nga aktiviteti i separacionit të rërës kuarcore, si dhe thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror, ndikimi kryesor mjedisor i lidhur me ajrin është gjenerimi i pluhurit mineral dhe emetimet nga mekanizimi transportues.

Burimet kryesore të ndikimit në ajër

Gjatë operimit të impiantit të “Kalimashi 1” Sh.p.k., ndikimet në cilësinë e ajrit paraqiten kryesisht nga:

- Pluhuri që lirohet gjatë shkarkimit të lëndës së parë në bunkerët e pranimit.
- Pluhuri gjatë procesit të thërrmimit (copëtim dhe imtësim i gurit gëlqeror).

- Pluhuri gjatë procesit të sitjes dhe klasifikimit të fraksioneve (seperracionit).
- Pluhuri gjatë bartjes së materialit përmes transportuesve me rripa.
- Pluhuri gjatë ngarkimit të fraksioneve në automjetet transportuese.
- Pluhuri nga rrugët e brendshme jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale.
- Gazrat e djegies (NO_x, CO, PM) nga makineritë e ngarkimit dhe mjetet e transportit.

6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër

Emisionet potenciale të gazrave dhe grimcave pluhuri mbeten brenda normave të lejuara për zonat industriale sipas standardeve mjedisore në fuqi. Nuk pritet tejkalim i përqendrimeve të SO₂, NO₂, CO, PM₁₀ dhe PM_{2.5} në zonën përreth.

a) Pluhuri mineral (Materiale të grimcuara)

- TSP (Total Suspended Particles)
- PM₁₀ (grimca ≤10 μm)
- PM_{2.5} (grimca ≤2.5 μm)

Burimi: procesi i shkarkimit, thërrmimit, sitjes, transferimit të materialit dhe lëvizja e automjeteve në rrugë të brendshme.

b) Gazrat nga makineritë dhe automjetet

- Monoksid karboni (CO)
- Okside azoti (NO_x)
- Dioksid sqfuri (SO₂ – në sasi shumë të ulëta)

Burimi: ngarkues, ekskavatorë dhe automjete transportuese.

6.4. Ndikimi i projektit në klimë

Projekti i kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k. është një aktivitet industrial me procese mekanike (thërrmim, sitje, transport me rripa), pa procese termike, pa djegie industriale dhe pa përdorim të substancave kimike reaktive. Për rrjedhojë, ndikimi në klimë është kryesisht i lidhur me:

- Konsumin e energjisë elektrike për operimin e pajisjeve.
- Konsumin e karburanteve fosile nga makineritë e ngarkimit dhe automjetet transportuese.

6.5. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit

Bazuar në:

- Natyrën mekanike të procesit,
- Karakterin sedimentues të pluhurit mineral,
- Intensitetin e kufizuar të emetimeve,
- Shkallën lokale të operimit,

mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit vlerësohet si e papërfillshme (neglizhueshme). Ndikimet e projektit janë të natyrës lokale dhe nuk kanë potencial për të shkaktuar transport të ndotësve në distanca të gjata apo përtej kufijve shtetërorë.

6.6. Cilësia e ujit

Gjatë funksionimit të impiantit për separacionin e rërës kuarcore dhe thërrmimin/separimin e gurit gëlqeror, ndikimet negative në ujë janë të kufizuara dhe kryesisht të lidhura me kontaktin e ujërave me materialin e përpunuar dhe aktivitetet e shërbimeve të impiantit. Burimet kryesore të ndotjes mund të jenë:

- Ujërat e përdorur për larje dhe spërkatje gjatë thërrmimit dhe imtësimit të materialit. Spërkatja përdoret për kontrollin e pluhurit dhe mund të përmbajë grimca të imta të gurit që mund të përhapen në tokë ose të përfshihen në ujëra sipërfaqësore.
- Ujërat që kontaktojnë materialin e imtësuar dhe pluhurat në sipërfaqen operationale. Këto ujëra mund të transportojnë grimca minerale drejt zonave përreth ose në tokën e ngushtë përreth lokacionit, sidomos gjatë reshjeve atmosferike.
- Derivatet dhe vajrat e makinerive transportuese dhe ngarkuese që përdoren brenda impiantit. Në rast rrjedhjeje ose derdhjeje aksidentale në tokë, këto substanca mund të arrijnë ujërat sipërfaqësore ose të depërtojnë në shtresat e ujit nëntokësor.
- Derivatet dhe vajrat nga mirëmbajtja e makinerive dhe pajisjeve të impiantit, përfshirë gjeneratorin për furnizim me energji elektrike, nëse përdoret. Mirëmbajtja rutinë e pajisjeve mund të krijojë rrjedhje të vogla të vajrave në tokë, të cilat mund të transportohen me ujërat e reshjeve.
- Ujërat e reshjeve atmosferike që rrjedhin mbi sipërfaqen ku janë vendosur fraksionet e rrëres dhe mbeturinat e materialeve të imtuara. Këto ujëra mund të përmbajnë grimca të gurit dhe pluhur, duke krijuar ujëra sipërfaqësore të përzier.

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Në lokacionin ku do të zhvillohen aktivitetet e separacionit dhe thërrmimit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, ndikimi kryesor i ndotësve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore lidhet me aktivitetet mekanike dhe operimin e impiantit. Ky ndikim është i kufizuar dhe i menaxhueshëm, për shkak të natyrës së procesit dhe masave teknike të parashikuara.

Burimet kryesore të ndotjes së ujërave

1. Ujërat e larjës dhe spërkatjes gjatë thërrmimit dhe selektimit të materialit – këto ujëra përmbajnë grimca minerale të imta dhe mund të rrjedhin sipërfaqësisht drejt kanalizimeve ose tokës, duke ndikuar në përqendrimin e pluhurit dhe mineraleve në ujëra sipërfaqësore.
2. Pluhuri dhe grimcat e gurit të imtuar – gjatë reshjeve, këto grimca mund të transportohen nga sipërfaqet operative drejt lumenjve, përrenjve ose tokës, duke ndikuar në turbullimin dhe përqendrimin e mineraleve në ujërat sipërfaqësore.
3. Derivatet dhe vajrat nga makineritë transportuese dhe pajisjet e impiantit – rrjedhjet aksidentale mund të depërtojnë në shtresat e ujit nëntokësor ose të transportohen me ujërat sipërfaqësore, duke rritur përqendrimin e substancave organike dhe kimike.
4. Ujërat e reshjeve që kontaktojnë materialin e depozituar dhe rrugët e brendshme jo të asfaltuara – këto ujëra mund të mbajnë grimca dhe pluhur, duke ndikuar në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe potencialisht në infiltrimin e ujërave nëntokësore.

Efektet në cilësinë e ujërave

- Ujërat sipërfaqësore: përqendrimi i pluhurit dhe mineraleve mund të rrisë turbullimin dhe sedimentimin në lumenjtë ose përrenjtë pranë impiantit. Megjithatë, për shkak të konfiguracionit të terrenit, largësisë nga burimet e ujit dhe barrierave të planifikuara, këto efekte mbeten kryesisht brenda lokacionit.
- Ujërat nëntokësore: ndikimi mund të shfaqet përmes rrjedhjeve të vogla të derivateve dhe vajrave, ose përmes infiltrimit të ujërave të reshjeve që bartin grimca. Masat preventive dhe kontrolli i ujërave të përdorur zvogëlojnë rrezikun e kontaminimit të ujërave nëntokësore.

6.8. Mundësia e ndikimit në ndotjen ndërkuftare të ujërave

Aktiviteti i separacionit, thërrmimit dhe selektimit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore në lokacionin e kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k. ka ndikim të kufizuar dhe të menaxhueshëm mbi ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Duke marrë parasysh pozicionin e lokacionit, largësinë nga

lumenjtë kryesorë që mund të rrjedhin drejt kufirit (p.sh. Drini i Bardhë në drejtim të Shqipërisë), dhe masat preventive që kompania ka parashikuar ndërtimin e vaskave sedimentuese, rreziku i ndotjes ndërkufitare është minimal.

Faktoret që zvogëlojnë ndikimin ndërkufitar:

1. Largësia nga lumenjtë ndërkufitarë – Lokacioni ndodhet rreth 1.15 km larg lumit Drini i Bardhë, i cili ka rrjedhje drejt Shqipërisë, por rrjedhat e ujërave nga impianti janë të kontrolluara përmes sistemeve drenazhi dhe barrierave mbrojtëse.
2. Kontrolli i ujërave të përdorura – Ujërat e spërkatjes dhe ujërat e reshjeve të kontaktuara me materialet depozitohen dhe, nëse është e nevojshme, trajtohen para shkarkimit në rrjetin e ujërave sipërfaqësore.
3. Masat mbrojtëse për vajra dhe derivate – Rrjedhjet e mundshme nga makineritë, stabilimentet dhe generatorët kapen në basene kontrolluese, duke parandaluar depërtimin drejt rrjedhave natyrore dhe më tej drejt ujërave ndërkufitarë.
4. Topografia dhe relievi i terrenit – Formacioni i terrenit dhe pozicionimi i lokacionit kufizojnë rrjedhjen e ujërave me materiale të imta përtej territorit të impiantit, duke zvogëluar mundësinë e transportit të ndotësve drejt kufirit.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike

Ndryshime të dukshme hidromorfologjike nuk parashikohen, pasi nuk ka shkarkime të mëdha të ujërave ose ndërhyrje në rrjedhat natyrore.

6.10. Toka

Aktualisht toka në të cilën planifikohet të zhvillohet aktiviteti i lartëcekur është dëmtuar nga aktiviteti i seperacionit/thërrmimit dhe nuk përdoret si tokë bujqësore. Gjatë realizimit të procesit teknologjik për seperacion, thërrmimin dhe përpunimin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, ndikimet negative në tokë janë kryesisht në humbjen e pjelloris së tokës bujqësore. Këto ndikime lidhen kryesisht me natyrën mekanike të procesit dhe llojin e materialeve të përpunuara.

Burimet kryesore të ndikimit në tokë:

1. Depozitimi i fraksioneve të pluhurit – Kur guri gëlqeror dhe rera kuarcore transportohen dhe futen në impiant, një pjesë e materialit shumë i imët depërton në tokë. Ky pluhur është kryesisht inert dhe nuk përbën rrezik të madh toksik, por kërkon menaxhim të mirë për të parandaluar përhapjen e tij jashtë hapësirës së operacionit.

2. Mbeturinat e ngurta – Gjatë procesit krijohen mbeturina inorganike si pjesë të materialeve të përpunuara, mbetje nga pastrimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Këto mbeturina ruhen dhe grumbullohen në hapësira të veçanta për trajtim ose ripërdorim teknik.
3. Pluhurat nga sitja dhe imtësimi i materialit – Procesi i thërrmimit dhe sitjes çon në krijimin e pluhurit të imët që depozitohet në sipërfaqe të tokës. Masa parandaluese përfshin spërkatjen me ujë në pikat kritike dhe vendosjen e barrierave për mbajtjen e materialit brenda impiantit.
4. Ngjeshja e tokës nga makineritë punuese – Lëvizja e automjeteve transportuese dhe makinerive të rënda mund të shkaktojë ngjeshje të tokës në rrugët e brendshme dhe zonat operative. Kjo ndikon në strukturën e tokës, por zgjidhet me menaxhim të trafikut të brendshëm dhe përforsim të sipërfaqeve operationale.
5. Korrozioni dhe dëmtimi i pajisjeve – Elementet metalike si tubacionet hidraulike dhe pjesët e makinerive mund të përjetojnë korrozion ose rrjedhje të lubrifikantëve. Këto rrezikojnë ndotjen e tokës, por përballohen me mirëmbajtje të rregullt, inspektime teknike dhe vendosjen e baseneve mbrojtëse për kapjen e rrjedhave të mundshme.

6.11. Ndikimi fizik dhe topografia

Gjatë zbatimit dhe funksionimit të impiantit për thërrmimin dhe separimin e gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, topografia e lokacionit mund të pësojë ndryshime të kufizuara. Ngjeshja e tokës nga makineritë e rënda dhe automjetet transportuese mund të shkaktojë kompresion lokal të sipërfaqes, veçanërisht në rrugët e brendshme dhe zonat operative. Masat parandaluese përfshijnë rrugë të brendshme të përforsuara dhe zonat e manovrimit të pajisjeve për të minimizuar deformimet e tokës.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në tokë

Emetimet e pluhurit të krijuara gjatë thërrmimit, seperimit të materialit depozitohen pjesërisht në sipërfaqen e tokës. Pluhurat janë kryesisht inertë, por mund të ndikojnë në pamjen e sipërfaqeve operative dhe përreth impiantit pa masa mbrojtëse. Zbatimi i sistemit të spërkatjes me ujë dhe ndërtimi i hapësirave të grumbullimit të materialit reduktojnë përhapjen e pluhurit dhe ndotjen lokale të tokës.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Projekti ka ndikim të kufizuar në shfrytëzimin e tokës, pasi impianti është i vendosur mbi tokë bujqësore të degraduar dhe pjesërisht të mbuluar me rërë. Ky si projekt nuk ka shfrytëzim të tokave pyjore apo të resurseve ujore, ndersa lenden e parë kompania e merre nga kompanite tjera të licencuara. Masat e menaxhimit të mbeturinave dhe rrjedhave të vajrave sigurojnë që burimet natyrore të mos ndoten dhe të mbeten të qëndrueshme.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Zbatimi i projektit ka shkaktuar humbje minimale të tokës bujqësore, duke marrë parasysh që pjesa e lokacionit është e degraduar dhe me vlera të ulëta prodhuese. Pjesa e tokës që përdoret për rrugët e brendshme dhe zonat operative nuk përbën humbje të konsiderueshme për aktivitetet bujqësore të zonës përreth.

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Nga aktiviteti i seperacionit dhe thërrmimit ndikimet gjeologjike dhe gjeomorfologjike janë të kufizuara. Procesi i thërrmimit dhe seperimit realizohet mekanikisht, pa ndërhyrje të thella në substratin e tokës, duke ruajtur strukturën natyrore të terrenit. Ndryshimet e lehta fizike në relief lidhen kryesisht me depozitimin e materialit dhe ngjeshjen e tokës në zonat operative.

6.16–6.19. Popullsia lokale dhe shëndeti

Aktiviteti i seperacionit, thërrmimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore mund të ketë ndikime të kufizuara në popullsinë lokale, kryesisht në zonat më afër impiantit. Faktorët që mund të ndikojnë përfshijnë:

- Ndotja e ajrit: Grimcat e pluhurit që lirohen gjatë thërrmimit dhe selektimit të materialit mund të bartën nga era, por për shkak të relievit, distancës së lokacionit nga vendbanimet dhe masave parandaluese (spërkatja me ujë, hapësirat të mbyllura për depozitimin e materialit) përhapja e tyre është minimale. Pluhuri mund të shkaktojë irritim të rrugëve respiratore, sidomos tek fëmijët dhe personat me sëmundje kronike të frymëmarrjes.
- Zhurma: Funksionimi i thërrmuesve, sitave vibruese dhe transportuesve me rripa gjeneron zhurmë. Nivelet e zhurmës janë të përqendruara kryesisht brenda impiantit dhe në rrugët e

brendshme, ndërsa vendbanimet më të afërta ndodhen mbi 350 metra larg, duke minimizuar ndikimin në shëndetin akustik të banorëve.

- Siguria në punë dhe shëndeti i punonjësve: Personeli i impiantit trajnohet për masat e sigurisë, përdorim të pajisjeve mbrojtëse (maska, syze, kapele mbrojtëse) dhe kontroll teknik të pajisjeve. Kjo redukton rrezikun nga pluhuri, zhurma dhe kontaktet me pajisje të rrezikshme.
- Rreziku nga ndotësit kimikë: Procesi është mekanik dhe nuk përfshin përdorim të substancave kimike ose djegie, kështu që nuk ka rrezik të ndotjes toksike për popullsinë lokale.

6.20–6.23. Ndikimet socio-ekonomike

Projekti i kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k. sjell përfitime socio-ekonomike kryesisht pozitive, duke rritur punësimin, aktivitetin ekonomik dhe infrastrukturën lokale, ndërsa ndikimet negative janë të kufizuara dhe të menaxhueshme përmes masave parandaluese dhe monitorimit të vazhdueshëm.

6.24–6.26. Ekosistemet dhe gjeologjia

Ndikimet në bimësinë dhe vegjetacionin:

- Zona e lokacionit për projektet e separacionit dhe thërrmimit të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore karakterizohet kryesisht nga bimë barishtore, shkurre dhe disa lloje të rralla drunjsh.
- Pjesa ku ndodhen impiantet është kryesisht e degraduar dhe e mbuluar me rërë, duke kufizuar vlerën e përdorimit bujqësor të tokës.
- Procesi i operimit nuk kërkon prerje të pyjeve ose ndryshime të mëdha në bimësinë ekzistuese, dhe për rrjedhojë ndikimi mbi ekosistemet bimore është i kufizuar dhe i menaxhueshëm.

Ndikimet në faunë dhe biodiversitetin lokal:

- Fauna në këtë zonë përfshin gjitarë të vegjël dhe të mëdhenj (lepur, derr i egër, dhelpra), zvarranikë (gjarpër, breshkë) dhe insekte të ndryshme.
- Zogjtë e zakonshëm përfshijnë bilbilat, çafkat dhe shqiponjat e vegjël.
- Procesi i impiantit dhe përdorimi i masave për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës minimizon ndikimet negative mbi faunën, duke mos kërcënuar popullatat lokale të kafshëve.

Ndikimet gjeologjike dhe gjeomorfologjike:

- Punimet për thërrmim dhe separim kryhen mbi tokë ekzistuese industriale ose tokë të degraduar.
- Aktivitetet e kompanisë nuk ndikojnë në strukturën gjeologjike bazë, nuk shkaktojnë rrëshqitje masive, dhe nuk rrezikojnë stabilitetin e terrenit.
- Çdo grumbullim materialesh dhe lëvizje makinerish monitorohet për të shmangur ngjeshjen e tepruar të tokës ose erozionin lokal.

6.27–6.29. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Sipërfaqet e planifikuara në lokacionin e kompanisë do të përdoren për realizimin e aktiviteteve të separacionit, thërrmimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror dhe të rërës kuarcore. Qëllimi kryesor është të krijohet një hapësirë e organizuar, funksionale dhe e sigurt për operimin e impianteve, duke mundësuar rrjedhë të vazhdueshme të procesit teknologjik dhe minimizim të ndikimeve negative në mjedis.

Sipërfaqet e planifikuara përfshijnë:

- Zonat e përpunimit (linjat e thërrmimit dhe separimit)
- Rrugët e brendshme për qarkullimin e mjeteve transportuese dhe makinerive
- Hapësirat për manovrim dhe parkim të mjeteve
- Trafostacionin dhe instalimet ndihmëse për furnizim me energji elektrike
- Hapësirat për depozitimin e materialeve dhe grumbullimin e fraksioneve të ndryshme

6.30–6.33. Infrastruktura komunale

- Trafiku: i kontrolluar, pa ndikim në rrugët kryesore.
- Furnizimi me ujë
- Energjia: e furnizuar nga KEDS/KES-Co.

6.34–6.35. Ujërat e zeza dhe gjenerimi i mbeturinave

- Trajtimi i ujërave të zeza: Duhet të ndërtohet gropa septike dhe trajtim i kontrolluar.

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore dhe kulturore

- Nuk ka pasuri të mbrojtura brenda ose afër parcelës.

6.37–6.44. Ndikimet nga implementimi dhe aksidentet

Pasi që aktiviteti i therrimit dhe sepermimit të gurit gëlqeror dhe pajimet tjera përcjellëse do të jenë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe njëherit kur dihet se brenda veprimtarisë nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, dhe duke pasur parasysh kapacitetin e punës, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese,
- Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes),
- Nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik,
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të produkteve.

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

7.1. Masat e parashikuara me legjislacion

7.1.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa: Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të therrimit dhe sepermimit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Meqëse kompania posedon thërmojsën që e përdor në gurëthyesin egzistues, për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania është e detyruar të bëjë instalimin e sistemit të ujit për zvogëlimin e sasisë së pluhurit. Furnizimi me ujë do të bëhet me cisternë, me anë të pompës së ujit nëpër mjet gypsjellësve sillet gjerë te pjesa e zgjeruar. Sistemi i ujit për zvogëlimin e pluhurit i cili lirohet gjatë procesit të therrimit dhe sepermimit të gurit gëlqeror, duhet të vendoset në tërë stabilimentet të cilat lirojnë pluhur dhe atë në bunkerin pranues, në gurthyesen primare me nofulla, gurthyesen sekondare dhe terciare, në të gjitha sitat vibruese, dhe në të gjithë shiritat transportues. Në sistemin për zvogëlimin e pluhurit duhet vendosur valvulet për lëshimin dhe rregullimin e sasisë së ujit në mënyrë mekanike, gjithashtu duhet të vendosën diznet të cilat e lëshojnë ujin në formë mjegulle e cila bënë ujitjen e materialit therrmues, dhe në këtë mënyrë masa e cila do të therrmohet, si dhe fraksionet ujiten ashtu që nga masa dhe fraksionet nuk mund të lirohet pluhuri. Uji i cili shërben për mënjanimin e pluhurit duhet të rregullohet ne

sasi vetëm sa të bëj rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen në mjedis, kjo sasi varret nga lagështia e gurit gëlqeror i cili klasifikohet dhe themohet.

Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të therrimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nëse me instalimet e sistemit të ujit nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Kompania duhet të bëjë instalimin e sistemit të depluhurimit me anë të filtrave që është sistem i avancuar për zvogëlimin e pluhurit dhe emisioneve. Në vijim po bëjmë përshkrimin e procesit teknologjik të depluhurimit. Pluhuri i cili krijohet gjatë procesit teknologjik thithet nga stabilimentet me ndihmën e ajrit përmes gypave që do të montohen në vendet ku krijohet pluhuri. Sasia e ajrit të thithur do të caktohet në bazë të përvojës dhe matjeve të bëra në pajimet e vendosura për shpluhrosje.

Në çdo vend për shpluhrosje do të ekzistojnë flutura rregulluese me të cilën rregullohet sasia e ajrit të thithur. Të gjithë gypat do të jenë ashtu të dimensionuar sa që shpejtësia e ajrit në ta është mjaft e madhe sa që nuk do të ketë palosje (fundërrim, ngjitje) të pluhurit në gypa. Të gjithë gypat thithës do të jenë të lidhur me gypin kryesor mbledhës të pluhurit i cili është i kyçur në filtrin OVF 350.

Në vendet lidhëse të gypave vendosen mbyllësit e gomës të cilët shërbejnë si mbyllës e njëherit edhe si izolator të ajrit.

Në filtrin e thatë prej bezi nga ajri i ndotur ndahet gati e tërë sasia e pluhurit d.m.th. bëhet filtrimi i ajrit përmes bezit filtrues. Efekti i kësaj ndarje është mbi 99 %. Koncentrimi i pluhurit në dalje nga filteri sillet nën 50 mg/m^3 e që është më pak se e lejuara 150 mg/m^3 . Filteri i bezit është i pajisur edhe me stabilimente për pastrimin e thasëve, përndryshe shtresat e pluhurit do të pengojnë krejtësisht filtrimin dhe punën e të gjitha pajimeve ose stabilimenteve. Pastrimi bëhet me ventilatorin për fryrje i cili me ndihmën e një mekanizmi largohet prej thesi në thes dhe bënë fryrjen e thasëve me lëvizjen e ajrit nën shtypje. Lëvizja e ventilatorit për fryrje prej thesit në thes dhe koha e pauzës në mes thasëve caktohet me ndihmën e releut kohor në programaturën e filterit. Ajri i pastruar nga filteri kalon përmes gypave në ventilatorin kryesor dhe prej aty në oxhak dhe del nga sistemi për shpluhërosje. Pluhuri i ndarë në filtër largohet me kërmill dhe hyn në dozatorin e transportierit pneumatik prej aty me ndihmën e ajrit të komprimuar transportohet në silos. Silosi është i pajisur me nivelues i cili regjistron nivelin maksimal në silos. Zbrazja e silosit bëhet me ndihmën e stabilimenteve për mbushje me dorë ose mekanike i cili kyçet në autocisternë. Për rrëzimin e pluhurit të shtresuar në pjesën konike të silosit bëhet me ajër të komprimuar. Kërmilli i

pjerrët transportues i cili transporton pluhurin nga pjesa e poshtme e filterit ku grumbullohet pluhuri ka një hapje plotësuese e cila shërben për pastrimin e tij.

Pajimet për shpluhrosje do të përbëhen nga këto elemente:

- a. filteri OVF-350 m² me beze të thatë,
- b. ventilatori centrifugal,
- c. gypat, lakesa, reduktor, flutura rregulluese, ndarës dhe oxhaku,
- d. transporter i pneumatik,
- e. silosi,

Pajimet dhe vendet ku duhet bërë largimi i pluhurit janë këto:

1. Gjatë procesit të transportimit të inerteve deri tek nofulla
2. Thërrmuesja me nofulla
3. Thërrmuesja sekondare dhe terciare me traj dhe çekan
4. Në hinkat për derdhje të materialit
5. Në sitat vibruese
6. Në shiritat transportues

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik për therrmim dhe seperim të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore, përpos masave të lartë cekura duhet ndërmarr edhe këto masa:

- Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve, e posaçërisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.
- Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvogëlimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filtër.
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues të dëmtuarit të ndërrohen.
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
- Gjithmonë duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve transportuese dhe fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.
- Duhet të jetë çdo herë në disponim auto cisterna me ujë për spërkatje.
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, në kohra të thata edhe të spërkatën me ujë.

- Duhet të bëhet matja e emisioneve dhe imisioneve të pluhurit gjatë punës në punishte dhe në territorin më të gjerë, duke iu përmbajtur të gjitha masave të cekura më lartë për mbrojtjen e ajrit, me qëllim të caktimit të sasisë së përbërjes së thërmijave të pluhurit, dhe për të krahasuar vlerat e matura më vlerat kufitare të caktuara.

7.1.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

- Duhet të ndërtohet sisteme drenazhimi për mbledhjen e ujërave sipërfaqësore, të larjës dhe spërkatjes, për të parandaluar rrjedhjen e tyre drejt lumenjve ose tokës.
- Kontrolli i rrjedhjeve të vajrave dhe derivateve nga makineritë dhe pajisjet, përmes mirëmbajtjes dhe përdorimit të baseneve kapëse.
- Vendosja e barrierave fizike dhe mbulimeve në zonat ku depozitohen fraksionet e materialit, për të parandaluar shpërndarjen e grimcave me ujë.
- Trajtimi paraprak i ujërave të përdorur për spërkatje përpara shkarkimit, në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore.

7.1.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Me qëllim të ruajtjes së tokës nga ndikimet negative gjatë procesit teknologjik të therrimit dhe seperimit, duhet ndërmarr këto masa:

- Me qëllim të mbrojtjes së tokës platoja ku janë të vendosur makinerit për therrim dhe seperim duhet të betonohet, izolohet dhe mbulohet me pullaz që të mos u ekspozohet ndotjeve.
- Depoja dhe servisi duhet të jetë në atë mënyrë që të jetë e mbuluar, platoja duhet të jetë me bazë betoni e cila duhet të jetë e izoluar me material anti acidik, ose të sigurohen kontejner për deponim të mbeturinave të ndryshme që janë rezistent ndaj fluideve acidike.
- Duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet operationale.
- Duhet të merrën masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluar për mos depërtimin e tyre në tokë dhe ate ne ofiçinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.
- Mbeturinat e ngurta komunale dhe inerte të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet

ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.

- Platoja dhe sipërfaqet operationale ku vendoset gjeneratori të betonohet dhe izolohet.
- Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes së pajimeve të gurëthyesit me seperacion duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe do të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.
- Depoja ku deponohen vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar të thurret me mur statik si dhe platoja (dysHEMEJA) të betonohet.
- Makinat ngarkuese dhe transportuese pas kryerjes se orarit të punës të parkohen në vendin e caktuar enkas për to.

7.1.4. Masat për mbrojtje nga zhurma

Kompania “Kalimashi 1” shpk me aktivitet seperacionit të rërës kuarcore, therrmimin dhe përpunimit të gurit gëlqeror, gjatë ushtrimit te aktivitetit të tij shkakton zhurme jo edhe aq të madhe, e cila është brenda kufijve të lejuar, kjo për shkak të procesit teknologjik të lartëcekur, nga ku zhurma më e madhe vjen nga therrmojsa për imëtsimin e gurit. Por duke marr parasysh se therrmojsat do te jenë të izoluara me sandvixh panele zhurma do të evitohet në masë të madhe. Megjithatë operatori duhet te marr te gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nen ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës ne kuadër te normave te lejuara, duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet te cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorëve te mjeteve motorike, duke mirëmbajt dhe duhet kushtuar rendësi e veçante te gjitha pajisjeve te cilat emitojnë zhurme gjate procesit te punës.

7.1.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peisazh, florë dhe faunë

Projektet e kompanisë “Kalimashi 1” Sh.p.k. kanë ndikime të menaxhueshme mbi ekosistemet lokale dhe gjeologjinë. Masat parandaluese, përfshirë kontrollin e pluhurit, mirëmbajtjen e rrugëve dhe menaxhimin e materialeve, sigurojnë që biodiversiteti dhe stabiliteti i terrenit të mbeten të paprekur.

7.1.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Për të minimizuar çdo shqetësim, operatori do të zbatojë masat e mëposhtme:

- Organizimi i aktiviteteve të impiantit në përputhje me oraret e lejuara për minimizimin e shqetësimit për banorët;
- Njoftimi paraprak i komunitetit për çdo aktivitet që mund të shkaktoj ndikim të përkohshëm;
- Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe motorëve të mjeteve motorike për të zvogëluar zhurmën dhe ndotjen nga pluhuri;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me komunitetin lokal për shqetësimet dhe kërkesat e mundshme që lidhen me aktivitetin minerar.

7.1.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të këtij impianti mund të vlerësohen si raste të izoluar. Për të mos ardhur deri te ndonjë aksidenti eventual investitori, duhet që të merren të gjitha masat adekuate paraprakisht. Rreziku më i madhe për ndonjë aksident vjen nga energjia elektrike si edhe pajisjet për therrmim dhe seperim.

Për të parandaluar dhe zvogëluar rreziqet e mundshme janë marrë dhe duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet i tërë oborri të thuret me tel gjembor,
- Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese si dhe nga pajisjet.
- Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- Të merrën të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës. Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.

7.1.7. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të kompanisë “Kalimashi 1” shpk me aktivitet të seperacionit të rërës kuarcore, therrmimin dhe përpunimit të gurit gëlqeror, mbeturinat që mbesin gjatë procesit të punës duhet të mblidhen dhe të trajtohen sipas nevojës para se të hudhen në kontinjer të mbeturinave. Mbeturinat

te cilat mbesin, mund të jenë mbeturinat të cilat i bënë personeli gjatë procesit të punës. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për mbetjet e mundshme të këtij aktiviteti, zgjidhja është si në vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina,
- Mbeturinat e mbetjeve të betonit, hekurit dhe gomës, do të merren nga kompania që është kontraktuar për këtë.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit është projektuar për të vlerësuar vazhdimisht ndikimet e aktivitetit të seperacionit dhe therrimit mbi komponentët kryesorë të mjedisit gjatë fazës së operimit të aktivitetit. Qëllimi është të sigurohet respektimi i normave mjedisore dhe të identifikohen devijimet, duke mundësuar ndërhyrje parandaluese ose korrigjuese për të mbrojtur ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin dhe shëndetin publik.

Monitorimi përfshin:

- Matje të indikatorëve mjedisore sipas standardeve dhe normave të përcaktuara në legjislacionin vendor;
- Vlerësimin e efektivitetit të masave mbrojtëse të implementuara;
- Raportimin e rezultateve tek autoritetet kompetente dhe publikimi i rezultateve për komunitetin lokal.

8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të aktiviteteve të projektit

Gjendja mjedisore para fillimit të projektit karakterizohet nga një zonë me përdorim gjysmë-natyror, me vegjetacion të rrallë dhe pa burime të ndjeshme mjedisore në afërsi të drejtpërdrejtë. Cilësia e ajrit, tokës dhe ujërave vlerësohet si e mirë dhe pa ndotje të konsiderueshme. Kjo gjendje shërben si bazë krahasuese për vlerësimin e ndryshimeve eventuale që mund të shfaqen gjatë realizimit dhe operimit të projektit.

8.3. Parametrat për përcaktimin e efektit të dëmshëm

Parametrat kryesorë të monitorimit përfshijnë:

A. Ajri

- PM₁₀ dhe PM_{2.5} (grimcat pezulluese)

- CO, NO₂, SO₂ (gaze ndotëse)

B. Ujërat

- Parametrat fiziko-kimik si;
- pH
- Oksigjeni i tretur
- Nitratat, fosfatet
- Temperaturë dhe turbullim, etj

D. Zhurma

- Niveli i zhurmës (dB(A)) në distanca dhe orare të ndryshme

E. Biodiversiteti

- Numri i specieve dhe vlerësimi i habitatit të zonës përreth

8.4. Vendndodhjet, mënyra dhe shpeshësia e matjeve

Vendndodhjet

Pikat e monitorimit përfshijnë:

1. Perimetri i impiantit (për ajër dhe zhurmë)
2. Zona përreth brenda 50–100 m (ajër, toka)
3. Vendbanimet më të afërta (350 m) (ajër, zhurmë)

Mënyrat dhe mjetet e matjes

- Matje me instrumente të standardizuara për ndotësit e ajrit.
- Analiza laboratorike për ujërat e shfrytëzuara dhe të shkarkuara.
- Përdorimi i matësve akustikë për zhurmën.

8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve

Struktura e raporteve të monitorimit duhet të përfshijë:

1. Përmbledhje e rezultateve të matjeve për çdo periudhë;
2. Krahasimi me normat ligjore dhe standardet e OBSH-së;
3. Analiza e devijimeve dhe trendet vjetore;
4. Rekomandime për masa korrigjuese;
5. Vizualizime (grafikë, tabela) të të dhënave të matjeve;

Raportet do të dorëzohen pranë autoriteteve kompetente (MMPH) dhe do të arkivohen sipas kërkesave administrative për Pëlqimin Mjedisor dhe Lejen mjedisore.

8.6. Detyrimi për të informuar publikun

Operatori ka detyrim të sigurojë informim të qartë dhe transparent të komunitetit për rezultatet e monitorimeve mjedisore, përmes:

- Publikimit të raporteve të monitorimit në faqen zyrtare dhe/ose në qendrat komunale të informacionit;
- Organizimit të takimeve periodike me komunitetin lokal për të prezantuar rezultatet dhe masat korigjuese;
- Disponimit të informacioneve të përmbledhura në formë të qartë (grafikë, tabela) për publikun.

8.7. Programi ndërkufitar i monitorimit të ndikimit në mjedis (sipas rastit)

Aktualisht, bazuar në natyrën e aktivitetit dhe ndikimet e vlerësuara (të lokalizuara dhe minimale), programi ndërkufitar nuk është i detyrueshëm, por parashikohet si pjesë e mekanizmave mjedisore nëse identifikohen ndikime më të gjera se sa pritej.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i Menaxhimit Mjedisor synon të sigurojë mbrojtje efektive të mjedisit gjatë fazës së ndërtimit, operimit dhe përfundimit të aktivitetit të impiantit për seperacion, thërrmimin dhe seperimin të gurit gëlqeror dhe rërës kuarcore. Gjatë fazës së operimit, fokusi do të jetë në funksionimin e sigurt dhe të kontrolluar të impiantit, mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve teknologjike, zbatimin e masave për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, si dhe menaxhimin e mbeturinave inerte. Aktiviteti zhvillohet kryesisht përmes proceseve mekanike, pa përdorim të substancave kimike të rrezikshme dhe pa gjenerim të ujërave të ndotura teknologjike. Në rast të përfundimit ose ndërprerjes së aktivitetit, do të zbatohet rehabilitimi i lokacionit, duke rregulluar sipërfaqet e prekura dhe duke rikthyer zonën në një gjendje të qëndrueshme dhe të sigurt për mjedisin.

9.2. Pajtueshmëria me Pëlqimin Mjedisor

Kompania “Kalimashi 1” SHPK garanton pajtueshmëri të plotë me Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga autoritetet kompetente, duke përfshirë:

- Zbatimin e të gjitha masave mbrojtëse të përcaktuara në dokumentin e Pëlqimit;
- Raportimin e rregullt të rezultateve të monitorimit në përputhje me kërkesat ligjore;
- Implementimin e planeve për ndërhyrje në rast tejkalimesh të normave të ndotjes, aksidentesh ose ngjarjesh emergjente;
- Mbajtjen e regjistrave të të gjitha aktiviteteve mjedisore për auditime të mëvonshme.

9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me ISO 14000

Plani parashikon zhvillimin e një Sistemi të Menaxhimit Mjedisor (SMM) sipas standardit ISO 14001, për të arritur përfitime të mëtejshme mjedisore dhe operacionale:

- Politika mjedisore e kompanisë: Angazhimi për përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore;
- Planifikimi dhe identifikimi i aspekteve mjedisore: Identifikimi i të gjitha aktiviteteve që mund të ndikojnë në ajër, ujë, tokë dhe biodiversitet;
- Trajnimi i stafit: Sigurimi që të gjithë punonjësit të jenë të informuar dhe të trajnuar mbi praktikatat e menaxhimit mjedisor;
- Kontrolli operacional: Zbatimi i procedurave të monitorimit, mbrojtjes dhe ndërhyrjes së shpejtë;
- Transparenca dhe raportimi: Publikimi i rezultateve dhe mbajtja e dialogut me autoritetet dhe komunitetin lokal.

10. KONKLUZIONE

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masat për parandalimin e tyre, intervistat dhe opinionet e mbledhura, aktivitetin që do të zhvillohet, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese, mund të konkludojmë si më poshtë:

Kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k., e cila merret me seperacionin e rërës kuracore, thërrmimin dhe përpunimin e gurit gëlqeror në zonën kadastrale Landovicë, Komuna e Prizrenit, vepron në interes:

- Të investitorit, për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e kapacitetit të prodhimit të fraksioneve të rërës;
- Të ekonomisë së vendit, pasi aktiviteti gjeneron të ardhura dhe i ofron komunitetit produkte cilësore të rërës;
- Të banorëve lokalë, për shkak se krijon mundësi punësimi dhe siguron një ambient të menaxhuar profesionalisht.

Në rast se kompania “Kalimashi 1” Sh.p.k. menaxhohet dhe mirëmbahen pajisjet në mënyrë profesionale, sipas standardeve të parashikuara, me respektimin e plotë të masave të rekomanduara në këtë raport dhe me bashkëpunim të ngushtë me autoritetet përkatëse, ky aktivitet konsiderohet krejtësisht i pranueshëm si nga aspekti mjedisor, ashtu edhe nga ai social dhe ekonomik.

Duke u bazuar në natyrën e aktivitetit, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale dhe plotësisht të kontrollueshme. Këto të dhëna konsiderohen të mjaftueshme për Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), dhe i propozojmë institucionit kompetent, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit dhe Hapësinor (MMPH), dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit “Kalimashi 1” Sh.p.k., me seli në Landovicë komuna Prizren.

11. BURIMET E TË DHËNAVE - LITERATURA

1. Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Prizrenit
3. MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013 (Vëllimi I). Prishtinë.
4. MMPH-AKMM (2008): Raport i gjendjes së mjedisit 2006-2007. Prishtinë.
5. MMPH-AKMM –IKMN (2008): Raport i gjendjes së natyrës 2006-2007. Design House. Prishtinë.
6. MMPH-AMMK (2010): Gjendja a Natyrës-Raport 2008-2009. UNDP. IN Design Prishtinë.
7. MMPH-IHMK – Buletini Hidro-Klimatologjik 2016,
8. MMPH_IHMK – Resurset Ujore te Kosves 2015,
9. MMPH-IHMK – Vjetari Hidrometeorologjik 2014,
10. mmpH-rks.org/Ligjet 15. Osmani, J. (2008): Vendbanimet e Kosovës.
11. Ligjet dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e raportit të VNM-së

12. SHTOJCA

Bashkëngjitur këtij raporti gjeni:

- Certifikata e biznesit me veprimtari
- Certifikata mbi të drejtat e pronës
- Kopja e planit
- Informimi komunal
- Situacioni i terrenit nga gjeodeti i licencuar